



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

FAKULTETI I DREJTËSISË
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

TEZA:

**“Vepra penale vrasje e kualifikuar në territorin e gjykatës themelore
Tetovë për periudhën 2013-2018”**

Kandidat:

Haki Salihi

Mentor:

Doc.Dr. Vedije Ratkoceri

QERSHOR, 2020

Deklarata e autorsisë

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës së magjistraturës së paraqitur është punë origjinale e shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonje institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Te gjitha referencat dhe citimet ne tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota.

Me respekt

Haki Salih

()

PËRMBAJTJA

Abstrakt.....	8
Abstract.....	9
Hyrje.....	10
Qëllimi i hulumtimit.....	11
Metodologjia e hulumtimit.....	12
Hipotezat.....	13

Kapitulli I

Vepra penale vrasje e kualifikuar-aspekte të përgjithshme

1. Vështrime të përgjithshme mbi vrasjet e kualifikuara.....	14
2.Përkufizimi i termit vrasje e kualifikuar.....	15
2.1.Dallimi mes vrasjes së kualifikuar dhe vrasjes së rëndomt.....	15-16
3.Llojet e vrasjeve të kualifikuara.....	17
3.1.Vrasje në mënyrë mizore.....	18
3.2.Vrasje në mënyrë tinzare.....	19
3.3.Vrasje me qëllim fitimit të dobisë pasurore.....	20
3.4.Vrasje me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale.....	21
3.5.Vrasje me ç’rast rrezikohet jeta e personave tjerë.....	22
3.6.Vrasje nga hakmarrja e paskrupullt.....	23

3.7.Vrasje nga motivet e ulta.....	24
3.8.Vrasje në bazë të porsisë.....	25
3.9.Vrasje e gruas shtatzënë	25

Kapitulli II

Aspekti fenomenologjik dhe etiologjik i vrasjeve të kualifikuara

1.Ecuria dhe vëllimi i veprave penale të vrasjes.....	26-27
2.Mosha dhe gjinia e kryerësve të vrasjeve të kualifikuara.....	29
3.Arsimimi dhe statusi social i kryerësve të vrasjeve të kualifikuara.....	30-31
4.Faktorët e jashtëm.....	32
4.1.Faktorët ekonomik-social.....	32
4.1.1.Varfëria	33
4.1.2.Papunësia.....	33-34
5.Faktorët ideopolitik.....	35
5.1.Luftrat dhe konfliktet e armatosura.....	35-36
5.2.Përndjekjet politike.....	37
6.Faktorët mikrogrupor.....	38
6.1.Familja dhe rrethanat familjare	38-39
6.2.Shkolla dhe ambienti shkollor.....	40-41

6.3.Mjedisi që na rrethonë.....	41
7.Faktorët sociopatologjik.....	42
7.1Alkoolizmi	42--43
7.2.Narkomania	43-44
7.3.Prostitucioni.....	44-45
7.4.Bixhozi.....	45-46
8.Faktorët e brendshëm.....	47
8.1.Personaliteti	47-49
8.2.Karakter.....	48-49
8.3.Temperamenti.....	49-50
8.4.Shprehitë.....	51-52
8.5.Emocionet.....	53-54
8.6.Motivet.....	54-56
8.7.Inteligjenca.....	56-57
8.8.Çrregullimet mendore.....	57-59

Kapitulli III

Masat parandaluese në luftimin e vrasjeve të kualifikuara

1.Aspekte të përgjithshme lidhur me parandalimin	60
2.Aspekti preventiv në parandalimin e vrasjeve të kualifikuara.....	61
2.1.Shkollimi dhe arsimimi.....	61-62
2.2.Mjetet e komunikimit masiv	63
2.3.Zhvillimi ekonomik.....	64
3.Lufta represive ndaj kriminalitetit.....	65
3.1.Institucione kompetente në luftimin e vrasjeve të kualifikuara.....	66
3.2.Policia.....	66
3.3.Prokuroria.....	67
3.4.Gjykata.....	68-70
3.5.Entet penitensiare.....	70-71
4.Ndihma,mbrojtja dhe kompenzimi i viktimave të vrasjeve të kualifikuara.....	71-72

Kapitulli IV

Studimi empirik dhe paraqitja e të dhënave statistikore

1.Pasqyrë e përgjithshme lidhur me të dhënat statistikore të siguruar nga enti statistikor lidhur me vrasje të kualifikuara.....	73
--	----

1.1.Grafikon lidhur me të dhënat statistikore.....	74-75
2.Analizë e aktgjytimeve të Gjykatës Themelore në Tetovë.....	76-85
Përfundimi dhe rekomandimet	86-89
Biblografia.....	90-92

Abstrakti

Në këtë hulumtim shkencor do të flitet lidhur me veprën penale vrasje e kualifikuar e cila po shqetëson dhe njëkohësisht po rrezikon shoqërinë në tërësi.

Në kapitullin e parë të punimit është analizuar aspekti juridiki i vrasjeve të kualifikuara si për shembull nocioni, llojet, dallimet me vrasjet e rëndomta ose vrasjet e privileguara si dhe aspekte krahasimore me shtetet fqinje lidhur me vrasjet e kualifikuara.

Gjatë realizimit të punimit hulumtues janë shfrytëzuar metoda të ndryshme si metoda krahasimore, grafike, normative dhe statistikore për ta pasuruar edhe më shumë hulumtimin. Po ashtu në hulumtim do të flitet edhe për llojet e veprave penale vrasje e kualifikuar, shkaqet të cilat kanë dërguar në paraqitjen e të njejtave si ato etiologjik edhe ato fenomenologjik, pastaj masat të cilat ndërmeren nga ana e organeve shtetore kompetente për patandalimin dhe luftimin e kriminalitetit po ashtu ndihmën e cila u jepet viktimave të vrasjeve të kualifikuara por edhe viktimave të krimit në përgjithësi.

Si dhe në kapitullin e fundit do të flitet konkretisht për rastet të cilat janë zgjidhur nga ana e Gjykatës Themelore në Tetovë dhe të dhënat statistikore lidhur me rritjen apo zvoglimin e këtij lloji të kriminaliteti në përgjithësi.

Abstract

This scientific research will discuss the criminal act of qualified murder which is disturbing and at the same time threatening society as a whole.

The first chapter of the paper examines the legal aspects of qualified murder such as the notion, types, differences with murder and qualified murder, privileged murder as well as comparative aspects with neighboring states regarding qualified murder.

During the research, various methods such as comparative, graphical, normative and statistical methods were used to enrich the research. The research will also talk about the types of criminal offenses qualified murder, the causes that led to the presentation of the same as the etiological and phenomenological ones, and then the measures that were undertaken by the state authorities responsible for preventing and combating their criminality as well as assistance to victims of qualified murder but also to victims of crime in general.

As in the last chapter, the cases that have been resolved by the Basic Court in Tetovo and the statistical data related to the increase or decrease of this type of crime in general will be discussed.

Hyrje

Në këtë tezë të magistraturës të titulluar: “Vepra penale vrasje e kualifikuar ne territorin e Gjykatës themelore Tetovë për periudhën 2013-2018” do të hulumtohet lidhur me vrasje te kualifikuara duke pasur parasysh që në masë jazhtëzakonisht të madhe ka ndikuar në rrethin e gjykatës në fjalë por kjo lloje vepre edhe në tërë territorin e shtetit po shfaqën pasoj shumë të mëdha.

Rrezikshmëria e lartë nga ky lloj kriminaliteti paraqet një arsye shtes për hulumtimin e fenomenit te vrasjeve te kualifikuara ku ne këto lloj veprash bëjnë pjesë vrasje nga motive të ulta,në mënyr tinzare, privimi nga jeta e personit tjetër me crast vë në rrezik edhe jetën e personave tjerë, privimi i tjetrit nga liria me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, fshehjes apo kryerjes së ndonjë vepre tjetër penale,privimi nga jeta nga hakmarja,vrasja në bazë të porosisë dhe vrasja e gruas shtatzënë.

Duke pasur parasysh gamën e gjërë të veprave që përfshin ky lloj emërtim është më se e nevojshme që të studijohet dhe të analizohet në mënyrë të detajuar ky lloj i veprës penale.

Në mënyrë të detajuar do të hulumtojm cilët janë faktorët që ndikojn në menyre direkte si dhe indirekte në paraqitjen në shoqëri këto lloj të veprave penale.

Në këtë hulumtim po ashtu do të analizohen edhe aspektet empirike të këti fenomeni sic janë zhvillimi dhe përhapja e tij në shoqëri. Analizimi i aktgjykimeve nga Gjykata në Tetovë dhe çfar rezultatesh janë arritur në aspektin e parandalimit dhe të luftimit të këtij lloji të kriminalitetit.

Qëllimet e hulumtimit

Shoqëria çdo ditë po zhvillohet me hapa gjigand në drejtim të përmisimit të standardit jetësor, kushteve të banimit, krijimi i jetës sa më të rehatëshme dhe të qetë por gjatë këtij procesi shpesh ka ngecje të natyrave të ndryshme, mosmarveshje dhe këto probleme shpesh dinë të jenë edhe faktor shumë i rëndësishëm në paraqitjen e aktiviteteve kriminale.

Pra siç e cekta më lartë ngecja në përmbushjen e nevojave të qenieve njerëzore sjell edhe sjelljet delikuede dhe kriminale duke filluar me vrasje, vjedhje, keqpërdorimi i pushteti për përfitime materiale dhe shumë forma të ndryshme që janë vetëm një hallkë në zinxhirin e trash të kriminaliteti në shoqëri dhe për atë shkak duhe të në mënyrë shkencore dhe profesionale që ti qasemi hulumtimit të fenomenit të kriminaliteti të vrasjeve të kualifikuara pasi që përbëjnë një kategori shumë të rrezikshme të kriminaliteti dhe pasojat janë të pa kthyeshme për vet shoqërin në tërësi.

Qasja në mënyrë objektive dhe me profesionaizëm këtij fenomeni do të ndihmonte në masë të madhe që të gjenden faktorët dhe shkaqet se përse po paraqitet ky fenomen, nuk mjafton një qasje sipërfaqësore në një fenomen i natyrës dhe rrezikshmëris së lartë siç është ky lloj kriminaliteti.

Qëlimi i hulumtimit do të ishte arritur nëse gjatë këtij procesi arrim të nxjerrim në pah se cilët faktor dhe shkaqe janë ato të cilët ndikojn në paraqitjen dhe që të mund që të eliminoheshte nga rrënjët kriminaliteti dhe jo vetm që ti pritëshin vetëm krahët.

Metodologjia e hulumtimit

Gjatë hulumtimit të vrasjeve të kualifikuara nevojiten metoda të ndryshme që të arrihet në mënyrë sa më të detajuar dhe profesionale të studiohet ky lloj kriminaliteti dhe të arrihet në parandalimin e të njëjtit.

Metoda normative është përdorur për të analizuar dispozitat ligjore të legjislacionit të RMV-së cilat parashohin veprën penale vrasje e kualifikuar në aspektet e përkufizimit pra nocionit, llojet e vrasjeve të kualifikuara dhe shumë të dhëna tjera të rëndësishme në këtë drejtim .

Metoda krahasuese do të zbatohet me qëllim që të bëjmë krahasimin e legjislacionit tonë penal me legjislacionin penal të shteteve fqinje, siç është Kosova dhe Shqipëria lidhur me vrasjet e kualifikuara, dhe krahasimin e të dhënave në lidhje me veprën penale vrasje e kualifikuar në territorin e Gjykatës Themelore në Tetovë, në periudhën prej vitit 2013 deri 2018.

Metoda statistikore do të përdoret për grupimin, sistematizimin dhe analizimin e të dhënave statistikore të cilat do të fitohen gjatë këtij hulumtimi në lidhje me rastet e zgjidhura dhe praktikën gjyqësore në shtetin tonë dhe në shtetet fqinje lidhur me veprën vrasje e kualifikuar.

Metoda grafike ku nëpërmjet të kësaj metode jemi munduar që të paraqesim grafikone të ndryshme për aspektet e vëllimit dhe dinamikës së vepës vrasje e kualifikuar.

Hipotezat

Gjatë hulumtimit të këtij problemi që po e tangon shoqërin tonë do të shtrojm disa hipoteza të cilat në fund të hulumtimi shkencorë do të vërtetohen ose do të konstatojm se nuk janë të vërteta.

Hipotezat që do të shtrohen janë:

- A janë faktorët objektiv apo subjektiv shkaktarët kryesor në paraqitjen e vrasjeve të kualifikuara apo që të dy llojet e faktorëve kanë ndikimin e tyre në shfaqjen e vrasjeve të kualifikuara?
- Sa ndikon niveli i arsimimit në paraqitjen e këtyre rasteve?
- Cilët kategori të personave janë më së shpeshti kryerës dhe cilët viktimë të vrasjeve të kualifikuara?
- Numri i rasteve shkon duke u zvogluar apo po shtohen rastet e vrasjeve të kualifikuara?

Kapitulli I

Vepra penale vrasje e kualifikuar-aspekte të përgjithshme

1. Vështrime të përgjithshme mbi vrasjet e kualifikuara

Kriminaliteti paraqet dukuri e cila është shumë e rrezikshme dhe një kohësishtë shfaqën pasoja të mëdha, duke shkaktuar vuajtje tek njerzit pa pasur parasyshë dallimet të cila i diferencojn njerzit në shoqëri të ndryshme. Po ashtu edhe vepra penale vrasje e kualifikuar është në të njëjtën shkallë me kriminalitetin në përgjithësi madje ka raste në të cilat pasojat janë shumë më të mëdha se disa vepra penale të tjera më të lehta. Duke ditur që me vrasje privohet nga jeta personi tjetër dhe i pamundësohet që i njëjti të vazhdoj jetën dhe të gëzoj të mirat materiale dhe të drejtat e tij të cilat i fiton në momentin e lindjes si qenje njerzore është absurde dhe e pa justifikueshme që një person të privohet nga jeta qoft nga këndvështrimi moral apo edhe shkencorë.

Në qoftë se nuk do të ishin përcaktuar me norma sjelljet shoqërore atëher kjo do të kontribonte në paraqitjen e një kaosi të madhë që fatkeqësisht shpesh jemi dëshmitarë për egzistencën e tij në shoqërit apo shtetet që janë në transicion. Pra rregullimi i sjelljeve të caktuara dhe shpallja e disa sjelljeve si të kundërligjshme dhe vepra penale ka kontribuar në shoqëri në masë jashtëzakonishtë të madhe për mbrojtjen e shoqëris dhe shmangien e sjelljeve devijante dhe të rrezikshme.

Nuk duhet haruar se ligjeve pozitive të cilat e sanksionojn dhe njëkohësisht e afirmojn të drejtën për jete dhe paprekshmërin e jetës së personit tjetër këtu vlen të ceket edhe Deklarata Universal për të drejtat e njeriut e cila në nenin e parë thotë që “Të gjithë njerëzit lindin të lire

dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi”¹

2. Përkufizimi i termit vrasje e kualifikuar

Me privimin e personit nga jeta nënkupton se i kemi mohuar të drejtën kryesore të drejtën për jetë e drejt kjo e cila nuk është dhënë nga qëniet njerzore por nga Zoti dhe për këtë shkak respektimi i kësaj të drejte është obligimi i përcaktuar edhe me kushtetutën e shtetit tonë në neni 10 në të cilin thuhet se pacënueshmëria e jetës dhe intergriteti trupor është vler kushtetuese dhe e njejta mbrohet nga cdo shkelje e mundëshme dhe cenimi i tyre që fatkeqësisht po shkelet me të madhe dhe po përdhohet si vler kryesore në shoqëri.²

Termi vrasje e kualifikuar paraqet privim të paramenduar të tjetrit nga jeta, e kryer në rrethana rënduese, të përcaktuara me ligj.³ Rrethanat rënduese janë ato të cilat e dallojnë vrasjen e rëndomt nga vrasjet e kualifikuara po ashtu kjo ndikon edhe në vështirsimin e pozitës të kryerësit para organeve të drejtësis.

Rrethanat të cilat e vëndojnë në pozitë më të rënd kryerësin mund të ndajmë në tre grupe edhe atë rrethanat që kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes, me subjektivitetin që lidhen me motivin e kryerësit, rrethanat që kanë të bëjnë me pozitën e viktimës ose me detyrimet e saj.

Rrethanat që kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes së veprës penale si për shembull vrasje në mënyrë mizore, vrasje në mënyrë tinzare, rrezikimi i jetës së personave të tjerë gjatë kryerjes së veprës penale.

¹<https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Universale%20e%20te%20Drejtave%20te%20Njeriut%20%281948%29.pdf>

² <https://www.sobranie.mk/kushtetuta-e-rm-s.nsp>

³ Zejneli.I, E drejta penale pjesa e posacme(cikël leksionesh),Tetovë 2007,faq.20

Rrethanat subjektive që lidhen me motivin e kryerësit të veprës penale janë vepra të kryera nga lakmia, hakmarja e paskrupullt, përfitmi i dobisë pasurore apo edhe fshehja e ndonjë vepre tjetër penale.

Rrethanat që kanë të bëjnë me detyrimet e viktimës, në këtë grup të rrethanave bëjnë pjesë raste kur vritet personi zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, vrasja e gjyqëtarit, avokatit apo edhe prokurorit janë situatat që mund të shfaqen në përditshmëri.⁴

2.1. Dallimi mes vrasjes së kualifikuar dhe vrasjes së rëndomt

Fillimisht para se të paraqesim dallimet e vrasjes së kualifikuar me vrasjen e rëndomt do të paraqesim nocionet e të njëjtave.

Me vrasje të kualifikuar sic e cekëm më lartë nënkuptojmë privimin nga jeta me paramendim në rrethana rënduese, rrethana këto të cilat kryerësin e vendosin në pozitë më të rëndë në aspektin e përgjegjësisë penale.

Ndërsa me nocionin vrasje nënkuptojmë atë veprë të kundërligjshme me anë të së cilës i meritohet jeta personit me dashje apo nga pakujdesia.⁵

Duke u bazuar në nocionet e lartë përmendura dallimet konsistojnë si vijon:

I-Mënyra e kryerjes-tek vrasjet e kualifikuara mënyra e kryerjes është ajo e cila e dallon nga vrasja e rëndomtë si për shembull vrasja e në mënyrë mizore dhe poshtruese, vënia në rrezik e jetës së personave të tjerë gjatë kryerjes së veprës penale.

II-Rrethanat subjektive janë ato që e dallojnë vrasjen e kualifikuar nga ajo e rëndomt me vet faktin se tek këto vrasje motivi i kryerjes së tyre lidhet me ndonjë interes pasuror apo dobi pasurore, fshehja e ndonjë vepre tjetër penale, pastaj vrasja në bazë të porosisë janë disa rrethana që bëjnë dallimin e këtyre veprave penale.

⁴ Po aty faq.20-21

⁵ Po aty faq.19-20

III-Rrethanat që lidhen me viktimën dhe detyrime e saj, vrasja e personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare për shembull vrasja e prokurirut publik dhe pamundësimi i vazhdimit të ndjekjes penale.

IV-Lartësia e dënimit është një element tjetër dallues mes këtyre dy veprave penale ku vrasja e kualifikuar dënim varësisht nga lloji i veprës së kryer është minimum dhjetë vite dhe lartë apo ka raste kur shqiptohet edhe burgim i përjetshëm, ndërsa tek vrasjet e rëndomta lartësia e dënimit fillon nga pesë vitesh dhe lartë.⁶

⁶ Osmani A. Kodi penal i Republikës së Maqedonisë: teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik Shkup, 2015

3. Llojet e vrasjeve të kualifikuara

Edhe pse qyteti jonë nuk shquhet për kriminalitet apo për vrasje por fatkeqësisht kohëve të fundit po rritet me të madhe numri i vrasjeve përfshir këtu edhe vrasjet e kualifikuara dhe për atë shak nevojitet një hulumtim më i detajuar për analizimin dhe përpunimin e llojeve të vrasjeve të kualifikuara.⁷

Në këtë hulumtim shkencorë jemi ndalur në llojet në vazhdim:

I. Vrasje në mënyrë mizore

II. Vrasje në mënyrë tinzare

III. Vrasje me qëllim fitimit të dobisë pasurore

IV. Vrasje me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale

V. Vrasje me c' rast rrezikohet jeta e personave tjerë

VI. Vrasje nga hakmarrja e paskrupullt

VII. Vrasje nga motivet e ulta

VIII. Vrasje në bazë të porsis

IX. Vrasje e gruas shtatzënë

⁷ <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>

3.1. Vrasje në mënyrë mizore

Me veprën vrasje në mënyrë mizore nënkuptojmë privimi nga jeta i personit duke i shkaktuar vuajtje të mëdha fizike dhe psikike viktimës. Pra kjo veprë penale realizohet duke i shkaktuar vuajtje dhe mundime fizike dhe psikike viktimës duke mos u mjaftuar me privimin nga jeta e viktimës.

Vuajtjet dhe lëndimet të cilat janë shkaktuar viktimës për nga intenziteti dhe kohëzgjatja e tyre e kalojnë kufirin e dhimbjeve normale.

Për egzistimin e lloji të veprës penale nevojiten të jenë të përfshira dy elemente edhe atë elementi objektiv dhe elementi i natyrës subjektive.

Natyra objektive shprehet në shkaktimin e dhimbjeve të mëdha dhimbje këto të cilat e tejkalojnë normalen dhe natyra subjektive konsiston në vetëdijen dhe dëshirën për të kryer këtë lloj veprë penale pra personi është i vetëdijshëm se me veprimet e veta po kryen një sjellje të kundërligjshme dhe po i shkakton viktimës vuajtje dhe mundime të mëdha.⁸

⁸Kambovski.V, Komentari i kodit penal të Republikës së Maqedonis, botimi i dytë, Shkup, 2011, .faq.677

3.2. Vrasje në mënyrë tinzare (dinake)

Me vrasje në mënyrë tinzare nënkuptojm kryerjen e të njëjtë akt me intenzitet të lartë me një fjalë ajo e tejkalon dinakërin dhe fshehtësin në krahasim me vrasjet tjera që kryhen me paramendim. Pra tek ky lloj i vrasje personi shfrytëzon besimin e krijuar tek viktimja, duke e mashtruar dhe nëpërmjet kësaj kryerësi i afrohet asaj dhe e kryen aktin penal.⁹

Në aspektin subjektiv kryerësi e shfrytëzon viktimin pra ai e shfrytëzon besimin e krijuar tek ajo dhe e kryen aktin duke e goditur “pas shpine viktimën” dhe kjo është forma edhe më lehtë që të kryehet akti pasi që kryerësi e njeh në një farë forme viktimën dhe e shfrytëzon këtë si përparësi për të kryer vrasjen.

Në aspektin objektiv vepra kryhet në mënyrë tinzare, dinake, të fshehtë dhe shpesh edhe në befasi.

Në vrasje në mënyrë tinzare nevojitet që të vërtetohet egzistenca e natyrës subjektive pra krijimim i besueshmëri dhe njëkohësisht mashtrimit dhe keqpërdorimi i besimit të krijuar për të kryer aktin e vrasjes.

Po ashtu edhe te vrasje me helmim duhet që të vërtetohet egzistenca e natyrës subjektive që të vërtetohet se është kryer vrasje në mënyrë tinzare pra ky është elementi që e dallon vrasjen tinzare nga vrasja e rëndomt që mund të kryhet po ashtu me helmimin e viktimës.

Njëjt edhe tek rasti i vrasjes së personit në pritë nevojitet që të vërtetohet egzistenca e natyrës subjektive pasi që kryerësi mund që më parë ta ketë dërguar në një lokacion të caktuar në të cilën është ngritur pritë, pra kryerësi e ka shfrytëzuar besimin e viktimës dhe të njëjtin e ka mashtruar dhe e ka dërguar drejt vdekjes.¹⁰

⁹ Sulemjanov.Z, Vrasjet në Maqedoni, Shkup, 1990, faq.60

¹⁰ Po aty, faq.679

3.3. Vrasje me qëllim fitimit të dobisë pasurore

Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore ekziston në rastet kur privimi nga jeta i personit tjetër kryhet me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjell ndonjë dobi pasurore.

Vrasja është mjet që të arrihet deri te dobia materiale për vete ose për tjetrin, që shprehet si zmadhim (p.sh.që të arrihet deri te pasuria e viktimës, deri te shpërblimi i premtuar ose që t'i shmanget zvogëlimit të pasurisë së kryerësit p.sh. që të mund të lirohet nga borxhi i vet ndaj viktimës.¹¹

Akti konsidrohet si i tillë edhe në qoftë se kryerësi ka paramenduar se mund të të ketë dobi pasurore për vete apo për dikënd tjetër, pra nuk është e domosdoshme që të arrihet deri tek fitimi i menduar.

Dallimi i vrasje me qëllim të fitimit të dobisë pasurore dhe grabitjes konsiston në atë që kryerësi gjatë kryerjes së grabitjes hasën në rezistenc nga ana e viktimës dhe ai e privon nga jeta viktimën dhe me këtë do të arrihet deri tek dobia pasurore ndërsa tek vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore kryerësi paraprakisht e ka të planifikuar dhe të menduar mirë kryerjen e aktit që të arrij deri tek dobia pasurore apo premtimi i caktuar.Pra dallimi është shumë i vogël në shikim të parë po që në realitet egziston.

Si shembull konkret mund të paraqesim raste nga praktika, vrasjen e prindërve që të arrihet deri tek trashëgimia e pasurisë milionshe.¹²

¹¹ Kodi penal i RM-së, neni 123 par.4

¹² Kambovski.V, Komentari i kodit penal të Republikës së Maqedonis, botimi i dytë, Shkup, 2011.faq.681

3.4. Vrasje me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale

Tek vrasja e kryer me qëllim të fshehjes apo të kryerjes së ndonjë veprë tjetër penale paraqitet atëher kur kryerësi do të privoj viktimën nga jeta për arsye se do të kryej ndonjë veprë tjetër penale apo me privimin nga jeta të viktimës do të pamundësohet që të zbulohet ndonjë veprë tjetër penale.

Pra tek ky lloj i veprës penale egziston dy padrejtësi apo dy akte penale që lidhen njëra me tjetrën. Tek rasti parë kryerësi e privon viktimën nga jeta që të kryej veprë penale si për shembull vrasja e rojes së bankës që të mund të kryehet vepra penale vjedhje, pra vepra penale e kualifikuar egziston pa marë parasysh se vepra tjetër është kryer në të vërtetë. Tek rasti i dytë bëhet fjalë për privimin e viktimës nga jeta që të mos zbulohet ndonjë veprë penale që është kryerë më herët.

Për shembull mund të paraqesim rastin kur personi duke menduar se ka kryer një veprë penale e cila në realitet nuk është e tillë dhe e privon nga liria një person tjetër me të vetmin qëllim që të fsheh veprën e cila nuk është veprë penale (delikt putative apo delikt i presupozuar).¹³

¹³ Kambovski, V. Komentari i kodit penal të Republikës së Maqedonis, botimi i dytë, Shkup, 2011 faq. 681-682

3.5. Vrasje me ç'rast rrezikohet jeta e personave tjerë

Vepra penale vrasje me çrast rrezikohet jeta e personave të tjerë paraqitet atëher kur kryerësi ndërmer veprim me të cilin do të vendose në rrezik jeta e personave të tjerë gjatë kohës kur ai është duke kryerë veprën penale. Kjo veprë penale shfaqet kur personi ka pasur vetëdije se me veprimet e vet do të rrezikohet edhe jeta e personave të tjerë pra bëhet fjalë për veprë me paramendim. Pra kryerësi ka qenë në vetëdije dhe njëkohësisht e ka dëshiruar shkaktimin e pasojës në fjalë.¹⁴

Për ekzistimin e kësaj vrasje të kualifikuar është e nevojshme egzistimi i rrezikut konkret të së paku një personi, përveç viktimës së vrasjes.

Tek natyra objektive duhet që të egzistoj paramendimi për kryerjen e vrasjes si dhe paramendimi për rrezikimin e jetës së personave tjerë.

Kjo lloj vepre penale do të egzistoj edhe nëse gjatë ekzekutimit të vrasjes do të privohet nga jeta edhe ndonjë person tjetër.

Si shembull konkret mund të paraqesim rastin kur personi A qëllon në drejtim të veturës me qëllim që të vritet kush do qoft që gjendet në vetur dhe fatkeqësisht është goditur dhe mbetet i vrarë një personë, në paramendim përfshihen edhe personat tjerë që gjenden në veturë dhe nuk u qëlluan dhe jeta e tyre është vendosur në rrezik.¹⁵

¹⁴ Sulemjanov.Z, Vrasjet në Maqedoni, Shkup, 1990, faq.67

¹⁵ Kambovski V.Komentar i kodit penal të Republikës së Maqedonis, botimi i dytë, Shkup, 2011, faq.680-681

3.6. Vrasje nga hakmarrja e paskrupullt

Ky lloj i veprës penale paraqet vrasjen e cila lidhet me hakmarjen edhe Kodi penal e ka të njëjtin përkufizim për vrasjen nga hakmarrja e paskrupullt.

Hakmarrja e paskrupulltka disa elemente të përbashkëta me hakmarrjen dhe gjakmarrjen, por ka edhe disa dallime të rëndësishme të cilat i përkasin vetë personalitetit të kryerësit të vrasjes nga hakmarrja, siç janë më shpesh: arsyeja që është shkak i kësaj forme të hakmarrjes, personi ndaj të cilit është drejtuar kjo vrasje dhe një varg rrethanash të tjera të cilat mund të gjejnë shprehje me rastin e kryerjes së veprës në fjalë.¹⁶

Hakmarrja konsiston në kthimin e të keqes me të keqe, dëmitit të shkaktuar me një dëm më të madhë ndaj individit apo fisit të tij.Ndërsa gjakmarja paraqet marjen e hakut me gjakë dhe kjo nuk perfundon deri sa të vriten të gjithë antaret e familje dhe fisit dhe këto të vrar duhet të jene meshkuj.Pra tek këto lloj të veprave penale mund të konsiderojm se egzistojn rregulla të përcaktuara lidhur me këto raste, ndërsa fatkeqësisht tek hakmarrja e paskrupullt mungojn “rregulla” të caktuara të cilat respektohen tek dy llojet e veprave penale të lartë përmendura.¹⁷

Hakmarrja e paskrupullt dallohet nga hakmarrja dhe gjakmarja duke pasur parasysh personin të cilit i drejtohet, personaliteti të kryerësit, pastaj dëmi i shkaktuar tek ky lloj i hakmarrjes nuk është në proporcionalitet me dëmin e shkaktuar më parë. Kryerësi tek hakmarja e paskrupullt hakmarrjen e tij e drejton kah personat e pafajshëm siç janë fëmijët, gratë, të moshuartit pra hakmarrja nuk është drejtuar drejt personit që e ka shkaktuar dëmin por ndaj personave të pa fajshëm.¹⁸

¹⁶ Kodi penal i RM-së, neni 123 par.6

¹⁷ Halili.R, Penologjia, Prishtinë, 2014, faq.30-31

¹⁸ Zejneli.I, E drejta penale pjesa e posacme(cikël leksionesh), Tetovë-2007, faq.23-24

3.7. Vrasje nga motivet e ulta

Duke pasur parasyshë se cekëm disa motive të ulta për kryerjen e veprave penale siç janë shfrytëzimi i besimit të krijuar tek viktima, vrasja për fshehjen e veprës penale të kryerë më parë apo edhe kryerjen e veprës së re penale, motivi për të fituar në aspektin material por këtu motive të ulta nënkupton të gjitha llojet tjera të motiveve për të kryer vepër penale.

Nocioni i vrasjes nga motivet e ulta nuk është përcaktuar me ligj, por mund të nxirret nga kontesti i tërë dispozitës dhe nga ajo që i karakterizon motivet e ulëta të sipër përmendura.¹⁹

Si shembull mund të paraqesim vrasjen e një femre me të cilën kryerësi ka patur lidhje dhe të njejtën e privon nga jeta me qëllim që të mund të martohe me një femër tjetër, apo edhe vrasja për motive nacional shoviniste që fatkeqësisht po paraqiten në vende të ndryshme këto lloje vrasjesh.

Po ashtu si motive të ulëta mund të paraqesim edhe egoizmin, urejtjen, ligësin, nacional-shovinizmin, varësin, keqpërdorimin dhe shumë motive tjera të ngjajshme në bazë të së cilave kryerësit duke u ndikuar nga këto motive shtyhen që të privojn nga jeta viktima të shumta.

Tek këto lloje të veprave penale praktika gjyqësore niset nga qëndrime etike, morale, dhe sociale dhe shumë të tjera. Për shembull mund të cekim xhelozin si një gjendje e veçantë në të cilën gjendet kryerësi dhe për atë shkak ai në këtë gjendje kryen veprën penale dhe kjo vepër në opinionin publik kjo sjellje konsiderohet si akt i pa ndershëm.²⁰

¹⁹ Kodi penal i RM-së, neni 123 par.7

²⁰ Kambovski V.Komentar i kodit penal të Republikës së Maqedonis, botimi i dytë, Shkup, 2011, faq.684

3.8. Vrasje në bazë të porosis

Nga vet termi mund të kuptojm se për çfarë lloj i veprës penale bëhet fjalë, pra vrasja në bazë të porosisë konsiston në atë që viktima vritet nga një personi i caktuar por në realitet vrasja është porositur nga dikush tjetër.

Pra bëhet fjalë për një vrasje mirë të organizuar për të arritur tek qëllimi i caktuar për ekzekutimin e viktimës, pra për egzistimin e kësaj veprë penale nevojiten dy persona njëri është personi i cili e porosit vrasjen dhe personi i cili e kryen pra kryerësi i dretjepërdrejtë.

Është me rëndësi të cekim se në këto raste kur kemi vrasje me porosi shpesh motivi i tyre mund të jetë për shkaqe politike apo edhe për shkaqe konkurrence në punë apo edhe shkaqe tjera të cila dërgojn në kryerjen e aktit të till. Tek këto vepra penale nuk lidhet gjithmon vetëm përfitimi material por shpesh paraqiten edhe shkaqe tjera të cilat dërgojn në kryerjen e këtyre veprave penale.²¹

3.9. Vrasje e gruas shtatzënë

Ky lloj i aktit penal konsiderohet si vepër e kualifikuar në momentin kur nga jeta privohet një femër shtatzënë dhe nuk ka rëndësi fare se cili muaj i shtatzanisë është gruaja. Pra në këtë llo të veprës penale kemi vrasje të dyfishtë, e para prvimi nga jeta e nënës dhe e dyta privimi nga jeta e foshnjes së pa lindur. Pra kryerësi duhet të ketë vetëdije të plot dhe po privon nga jeta një femër shtatzënë. Njohuria paraprake se bëhet fjalë për person shtatzënë e plotëson këtë vepër penale. Është me rëndësi të përmendim faktin se në rast se kryerësi nuk ka njohuri për shtatzaninë e gruas të cilën e vret atëher në bazë të ligjit kjo do të konsiderohet vrasje dhe kryerësi do të përgjigjet për veprën në varësisht nga rrethanat rënduese apo lehtësuese që do të paraqiten në rastin konkret.²²

²¹ Kodi penal i RM-së, neni 123 par.5

²² Kambovski V.Komentar i kodit penal të Republikës së Maqedonis, botimi i dytë, Shkup, 2011, faq.685.

Kapitulli II

Aspekti fenomenologjik dhe etiologjik i vrasjeve të kualifikuara

1. Ecuria dhe vëllimi i veprave penale të vrasjes

Duke pasur parasysh kompleksitetin e fenomenit të krimit në përgjithësi dhe vrasjeve duhet që në tërësi të analizohet dhe të studiohet ky fenomen, e veçanërisht hulumtimin në aspektet e ecurisë dhe vëllimit të vrasjeve të kualifikuara. Duke ditë se me aspektin vëllimor nënkuptojm aspektin kuantitativ të përhapjes të këtij lloji të kriminalitetit dhe fatkeqësisht të dhënat e siguruar nga praktika tregojn rritje rastesh të vrasjeve.


Më posht do të paraqesim grafikonin me të dhënat statistikore lidhur me vrasjet në teritorin e shtetit tonë ku shihet qart se kemi rritje të numrit të vrasjeve në vitet e fundit dhe kjo paraqet një të dhënë shumë alarmante për shoqërit tonë.²³

Nga viti 2000 deri më 31 gusht të vitit të kaluar, sipas të dhënave të policisë, në Maqedoni kanë ndodhur gjithsej 703 vrasje, në të cilat janë vrarë 735 persona. Nga këto vrasje 120 janë akoma të pazbardhura, përcjell Telegrafi Maqedoni.

Statistikat e policisë më tej thonë se numri më i madh i vrasjeve të pazbardhura është në periudhën e vitit 2003 dhe 2004. Në vitin 2003 ndodhën 75 vrasje ndërsa në vitin 2004 56 vrasje, gjithsej 36 vrasje gjatë këtyre viteve mbetën të pa zbuluara.²⁴

²³ Halili.R, Viktimologjia, Prishtinë 2011,faq.115-116

²⁴ <https://telegrafi.com/ja-sa-eshte-numri-vrasjeve-ne-maqedoni-nga-viti-2000/>



Vrasjet në Maqedonin e Veriut të kryera me armë zjarri.²⁵

²⁵ <https://www.osac.gov/Content/Report/Oea4cf69-2682-43e4-871f-15f4aeae3da3>

2. Moshë dhe gjinia e kryerësve të vrasjeve të kualifikuara

Moshë paraqet karakteristikë të rëndësishme të fenomenit kriminal. Shumë të dhëna statistikore, vendime gjyqësore dhe të dhëna nga ana e organeve tjera shtetërore që e vërtetojnë se grupmosha të ndryshme meren me aktivitete të ndryshme kriminale po ashtu nuk duhet haruar se edhe të dy gjinit janë të përfshira në kriminalitet.

Nga raporti vjetor i MPB-së i vitit 2013 paraqitet zvoglimi i numrit të vrasjeve në krahasim me vitet e kaluara kur në këtë vit janë 22 viktima ku numri më i madhë i viktimave është në Shkup me 8 viktima, pastaj me nga 2 viktima janë Tetova, Shtip, Kumanovë dhe me nga 1 viktima janë qytetet në vijim Radovish, Kratovë, Veles, Demir Hisar, Gostivar dhe Kavadarci.

Sipas gjinisë 15 viktima janë meshkuj dhe 7 janë femra të cilat kanë rënë viktima të kriminalitetit. Ndërsa në aspekte të moshës në këtë raport thuhet se viktima janë nga moshë 8 vjeçare dhe mbi 60 vjet. Fëmija 8 vjeçar ishte i vrarë nga babai, ndërsa 71 vjeçarja u vra nga djali i saj.²⁶

Tek vrasjet e kualifikuara më prezente janë disa grup moshë duke filluar nga moshë 25-30vjet, pastaj grupi i moshës 30-50 vjet dhe më pak grupi i moshës 60vjet.

Duke patur parasysh se grup moshat e reja janë prezente në kriminalitet por ato më shpesh janë prezent tek krimet e vjedhjeve, trafikim ilegal me lëndë narkotike, vjedhje të makinave ndërsa për dallim tek personat e moshave më të mëdha janë prezente tek krimet kundër jetës dhe trupit, dhunimeve, krimet të organizuar.

Po ashtu kryerës të vrasjeve të kualifikuara më së shpeshti paraqiten meshkujt ndërsa tek gjinia femrore ky numër është shumë më i vogël në krahasim me meshkujt dhe dita ditës po zvoglohet në tërësi. Femrat më së shpeshti janë prezent tek krimet kundër pronës, nderit dhe dinjitetit njerëzor dhe ato më së shpeshti janë si shtytëse dhe japin ndihmë dhe më pak janë kryerëse të drejtpërdrejta të krimeve.²⁷

²⁶ <http://www.mvr.gov.mk/>

²⁷ Sulemjanov.Z, Vrasjet në Maqedoni, Shkup, 1990, faq.173

3. Arsimit dhe statusi social i kryerësve të vrasjeve të kualifikuara

Jo më kot Viktor Ygos ka thënë se hapja e një shkolle do të thotë mbyllja e një burgu, duke shprehur qartë rëndësinë e jashtzakonshme të arsimit i cili ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e nivelit të individit në veçanti dhe shoqëris në tërësi. Në bazë të përfitimit të njohurive të reja njeriu arrin që të bëhet dikushi në jetë falë shkollimit cilësor dhe profesional.

Personat e shkolluar dhe të arsimuar më pak bien pre e veprimeve kriminale pasi që ata kanë njohuri paraprake lidhur me respektimin e ligjit, duke pasur shkollim të mirfillt këta persona më lehtë arrijnë që të punsohen dhe sigurojnë të ardhura për vete dhe familjet e tyre dhe kjo paraqet një faktor të rëndësishëm duke ditur që në shtetin tonë ekonomia është jo shumë stabile dhe shpesh individët kryejnë krime përfshirë këtu edhe vrasje të natyrave të ndryshme për të siguruar mbijetesën për vete dhe familjet e tyre.

Po ashtu një faktor tjetër në shfaqjen e aktiviteteve kriminale paraqitet edhe statusi social ku në qarqet e ndryshme shkencore ka dominuar mendimi se me aktivitete kriminale meren vetëm personat që kanë një gjendje të vështirë ekonomike, janë të papunë, shtresa të ulta mirëpo duke u zhytur në hulumtime shkencore dhe nga vet praktika vërtetohet se përveç shtresave të ulta që meren me aktivitete kriminale edhe shtresat e larta meren madje janë ato të cilët ndikojnë dukshëm në shfaqjen e kriminalitetit në përgjithsi, këtë fakt e vërtetojnë rrethanat në të cilat jetojmë në shtetin tonë ku fatkeqësisht kurupsioni, krimi i organizuar, apo ndryshe siç njihet me termin “kriminaliteti i jakave të bardha” është në kulm dhe kjo e vërteton edhe më tej se jo vetëm shtresat e ulta dhe me standart të ulët jetësor meren me aktivitete kriminale por edhe pushtetarët dhe personat e pasur janë të zhytur në kriminalitet. Në të shumtën e rasteve pushtetarët janë ata të cilët e stigmatizojnë shoqërinë dhe krijojnë përçarje në shoqëri dhe kjo pastaj mundëson në krijimin e hapsirave për konfrontim në mes individëve të cilët kanë interesa të kundërta mes tyre.²⁸

Nga të dhënat e siguruar nga enti shtetëror statistikor në vitin 2018/19 në studime deri diploma janë regjistruar 53667 studentë ky numër i studentëve është më i vogël në krahasim me vitin paraprak me 5.7%. Nga numri i përgjithshëm 87% janë regjistruar në Universitete shtetërore dhe vetëm 12.4% janë të regjistruar në Universitete private.²⁹

²⁸ Halili.R, Viktimologjia, Prishtinë 2011, faq.132-133

²⁹ <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSooptenie.aspx?rbtxt=29>

Numri i nxënësve të shkollave fillore të cilët janë regjistruar në vitin 2019/20 është 187.204 nxënës apo 0.5% më pak e numrit nga viti i kaluar.

Duke parë që numri i nxënësve dhe studentëve po zvoglohet ngadal kjo duhet që të paraqet një alarmë për institucionet kompetente që të reagojn lidhur me problemin në fjalë. Kjo dukuri është edhe si rezultat i emigrimit të familjeve në shtetet evropiane dhe kjo është edhe një tregues tjetër për gjendjen jo adekuate në shtetin tonë.³⁰

Nëse shikjom numrin e të divorcuarve në shtetin tonë duke filluar nga viti 2008 deri në vitin 2018 shohim se në 1000 banor përqindja e divorceve është sin ë vijim

2018	0.8%	divorce në 1000 banorë
2017	1.0%	divorce në 1000 banorë
2016	1.0%	divorce në 1000 banorë
2015	1.1%	divorce në 1000 banorë
2014	1.1%	divorce në 1000 banorë
2013	1.0%	divorce në 1000 banorë
2012	0.9%	divorce në 1000 banorë
2011	0.9%	divorce në 1000 banorë
2010	0.8%	divorcenë 1000 banorë
2009	0.6%	divorce në 1000 banorë
2008	0.6%	divorce në 1000 banorë ³¹

³⁰ <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbtxt=17>

³¹ <http://www.stat.gov.mk/IndikatorITS.aspx?id=2>

4. Faktorët e jashtëm

Faktorët aspo shkaqet që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit janë të klasifikuar në grupe dhe nën grupe të ndryshme por ndarja kryesore është ndarja në faktorët objektiv apo faktorët e jashtëm dhe subjektiv apo faktorët e brendshëm. Lidhur me atë që se cilet faktor kanë ndikim më të lartë në paraqitjen e kriminalitetit egzistojnë autor të ndryshëm të cilët theksojnë që faktorët e jashtëm kanë një rol determinues në paraqitjen e kriminaliteti përfshirë këtu edhe vrasjet e kualifikuara por edhe faktorët subjektiv nuk duhet lënë anash në ndikimin e tyre në paraqitjen e kriminalitetit. Tek faktorët e jashtëm do të elaborojmë në tërësi një numër goxha të madhë faktorësh të cilët kanë ndikuar dhe vazhdojnë me ndikimet e tyre si faktor kriminogjen në shoqëri për shfaqjen e kriminalitetit.

4.1. Faktorët ekonomik-social

Duke pasur parasysh që numri i papunësisë në shtetin tonë është 20.8% nga numri i përgjithshëm i personave të aftë për punë kjo tregon për gjendjen e vështirë që kalojnë qytetarët e shtetit tonë për të siguruar të ardhura mujore për mbajtjen e familjeve të tyre.³²

Problemi ekonomik në shtetin tonë fatkeqësisht po thellohet dita ditës dhe duke mos mjaftuar edhe gjendja e vështirë ekonomike po shfaqen edhe problemet e natyrave të ndryshme të cilat e vështirësojnë edhe më tej jetën e tyre. Duke u pamundësuar që qytetarët të jetojnë një jetë komode dhe me një standart jetësor të lartë ata po rrezikojnë egzistencën e tyre dhe kjo i shtynë që të merren me aktivitete kriminale, fillimisht ata detyrohen që të bëjnë punë të ndryshme që nuk u përshtaten tyre pasja zhyten në vepra penale si vjedhje, tregëti me lëndë narkotike dhe madje edhe kryerjen e vrasjeve të kualifikuara ku mund të cekim vrasjet me porosi apo edhe vrasjet nga hakmarja e paskrupullt. Nuk duhet haruar se edhe etiketimi i personave apo stigmatizimi i tyre për shkak të gjendjes së tyre të vështirë ekonomike-sociale paraqitet një faktor tejet i rëndësishëm në shfaqjen e kriminalitetit dhe kjo lloj tallje apo fyerje e ndjenjave të personave në shtetin tonë fatkeqësisht është shumë prezente dhe shpesh ata janë pre e viktimizimit nga ana e qytetarëve tjerë dhe kjo edhe më shumë e shton hendekun i cili gjendet mes shtresave të ndryshme në shoqëri dhe ndihmon në masë jashtëzakonisht të madhe në përhapjen e aktiviteteve kriminale. Nuk duhet haruar se zhvillimi i hovshëm i industrisë, zhvillimi i shpejtë në shoqëri në sferën ekonomike ngritja e standardit të lartë jetësor nga shtresat e larta të cilat e ekspozojnë këtë si të arritur të tyre dhe shtesat e ulta duke u munduar që edhe ato të

³² http://www.stat.gov.mk/KlucniIndikator_i_al.aspx

arin sa do pak nga standardi jesësor bijen pre e saj dhe futen në aktivitete kriminale për tu bërë të njejt si shtresat tjera.³³

4.1.1. Varfëria

Varfëria paraqitet si faktor me ndikim në paraqitjen e kriminalitetit sidomos në vendet në të cilat ende janë në tranzicion e sipër njejt si në shtetin tone ku fatkeqësisht mund të konsiderohet si faktor me ndikim të jashtëzakonshëm duke patur parasysh se një numër shumë i madhë i popullsis jeton me të ardhura shumë të ulta apo edhe në varfëri të skajshme. Shpesh qarqet e ndryshme politike mudnohen që ta mbulojn realitetin e hidhur të cilin e përjetojm për çdo ditë të jetëve tona.

Duke u bazuar në të dhënat e Programit botëror të ushqimit (ËFP) mbi 800 milion njerëz në botë vuajnë nga uria dhe kjo është një statistik shumë e frikshme për gjendjen reale në botë.

Çdo ditë, shumë burra dhe gra në të gjithë globin luftojnë për të ushqyer fëmijëve të tyre një vakt ushqyes. Në një botë ku ne prodhojmë mjaft ushqim për të ushqyer të gjithë, 821 milion njerëz, një në nëntë ende shkojnë në shtrat me stomak bosh çdo natë. Edhe më shumë një në tre persona vuajnë nga një formë e kequshqyerjes.³⁴

Format më të shpeshta të krimeve të cilat kryehen si rezultat i varfëris dhe kushteve të vështira për jetë janë vjedhjet, vjedhjet e imta, mashtrimet, prostitucioni, lypsaria, alkoolizmi dhe në fund të listës gjendet vrasjet dhe vrasjet e kryera shpesh janë si rezultat i pamundësis dhe gjendjes së vështirë në të cilën gjenden.

4.1.2. Papunësia

Ngjajshëm si varfëria edhe papunësia është një factor tjetër që përfshihet tek gjendja e vështirë ekonomike dhe sociale për shkak të së cilës kryehen krime të ndryshme përfshirë edhe vrasjet e kualifikuara.

³³ Militinovic.M, Kriminologjia, Prishtinë, 1982, Botimi shqip

³⁴ <https://www.wfp.org/zero-hunger>

199325 është numri i të papunëve në shtetin tonë nga numri i përgjithshëm i personave aktiv në shoqëri dhe kjo po ashtu është një tregues shumë i rëndësishëm për gjendjen e vështirë që po kalojmë, dhe kjo me siguri ndikon në shfaqjen e sjelljeve delikvente në shoqëri në tërësi. Papunësia ka ndikim negativ dukshëm tek vet individi por edhe tek shoqëria në përgjithësi, ky ndikim është si në aspektin psikik por edhe në aspektin fizik dhe shëndetsor tek personat të cilët vuajn nga ky problem.

Për shkak të papunësis shpesh paraqiten në familje problem të shumta, mosmarveshje, konflikte mes prindërve, femijëve dhe kjo dërgon në një gjendje psikike dhe shpirtërore të shkatruar dhe shpesh në këto situata të rinjtë e familjes largohen nga familja dhe fillojnë të meren me aktivitete kriminale për të arritur qëllimet e tyre që nuk kanë mundur që ti arrijn për shkak të gjendjes së vështirë sociale dhe kjo gjendje për çdo ditë vështirohet dhe shpesh këta të rinjë bijen shumë lehtë në kriminalitet dhe përfundojnë me dosje penale që në mosh të re e dhe shkatrojnë të ardhën e tyre.

Pra siç e cekam më lartë përveç gjendjes që mbijeton brenda në familje ajo gjendje shpesh nxitet edhe nga faktorët e jashtë, fyerjet nga pjesa tjetër e shoqëris janë një faktor tjetër që shtyn në përkeqësimin e gjendjes në familje. Përveç të rinjëve shpesh edhe të riturit duke u munduar që të krijojnë kushte më të mira për jetë për familjet e tyre ato bijen prapa e aktiviteteve të kundërligjshme dhe më tepër e vështirojnë gjendje se sa ndihmojnë në përmirësimin e saj. Në fillim ata fillojnë me konsumimin e alkoolit pastaj trafiket ilegale me lëndë narkotik, prostitucion e deri tek më e rënda privimi nga jeta personat që ata në atë gjendje të vështirë që ndodhen i konsideroj si armiq apo shkaktar për gjendje e tyre në të cilën ndodhen.

Kriminologu francez J.Konstant thekson se papunësia dhe varfëria janë problem të cilat më vonë ato hapin rrugë kriminalitetit në shoqëri, këto problem kanë ndikim të veçantë në paraqitjen e delikuencës së të miturve dhe kriminalitetit i të rinjëve.³⁵

³⁵ Halili.R, Viktimologjia, Prishtinë 2011, faq.248-249

5. Faktorët ideopolitik

Faktorët ideopolitik shpesh kanë ditur që të ndikjon në kriminalitet, nga vet emërtimi mund të kuptojm se konfliktet që paraqiten shkaktojnë pasoja në shoqëri me ndarjen e shoqëris dhe shfaqjen e aktiviteteve kriminale. Faktorët ideopolitik kanë ndikim të drejtpërdrejt por edhe indirekt në shoqëri, pra këto konflikte që paraqiten janë të natyrës politike, kulturore, arsimore dhe të traditave të ndryshme. Këto konflikte shpesh dinë të jene edhe shumë shkatrimtar për vet shoqërin duke pasur parasysh se mosmarveshjet janë pjes e shoqëris dhe në fund të fundit pasojat i sheh vet shoqëria.

Konfliktet politike e favorizojnë kriminalitetin e dhunës, korrupsionin, rryshfetin dhe krimin e organizuar. Kjo për vet faktin se konfliktet janë prezente mes klasave qoft politike qoft nacionale dhe këto konflikte shkaktojnë pasoja pasi që klasa e cila ka pushtetin në dorë dhe e shfrytëzon pushtetin për hakmarrje dhe vendosjen e pushtetit mbi ata që janë kundër tyre dhe nënshtrimin e tyre. Pra ata nuk e shfrytëzojnë pushtetin në favor dhe interes të shoqëris por për interes e tyre personale që sa më gjatë të qëndrojnë në pushtet.³⁶

5.1. Luftat dhe konfliktet e armatosura

Gjatë historis botërore njerzimi është ballafaquar me shumë lufta ku dy janë më shkatrimtare që njeh njerzimi me pasoj shumë të mëdha si në njerëz po ashtu edhe në dëme materiale, shkatrime të infrastrukturës, vendbanimeve. Nga ajo gjendje e krijuar paraqitet hapsira për veprim nga ana e organizatave kriminale që dinë shumë mir që ti shfrytëzojnë këto situatë në favorin e tyre.

Në literature lidhur me luftat autor të ndryshëm i kanë paraqitur tre etap të veprimit të kriminelëve, etapa e parë është etapa përgaditjes për luft në të cilën shteti e orienton ekonomin në furnizim me armatim dhe mjete tjera luftarake, qytetarët nxitojnë që të furnizohen me ushqime dhe gjësende tjera elementare për egzistenc, ku ekonomika fillon të tkuret dhe fillojnë ngadal të paraqiten kriza ekonomike dhe këtë gjendje më së mir e shfrytëzojnë organizatat kriminale për përfitimet e tyre personale.

³⁶Halili.R, Kriminologjia, Prishtinë 2008, faq.253

Etapa e dytë është vet lufta ku shkaktohen pasoja shumë të mëdha që shpesh janë edhe të pa rikuperueshme për shoqërin, shkatrime të vendbanimeve, vrasje të personave të pa armatosur, pleqëve, fëmijëve, grav. Në këto situata individ të ndryshëm e shfrytëzojnë duke u pasuruar në kuriz të luftës duke keqpërdorur fondet e ndryshme të siguruar.

Etapa e tretë është etapa e pas luftës kjo etap shpesh paraqitet si më e vështira pasi që në këtë etap nevojitet që të rimëkëmbet ekonomia e shtetit, rindërtim i infrastrukturës së shkatruar dhe jo më kotë thuhet se lufta nuk sjell asgjë tjetër pos shkatrimeve. Në këtë periudh të pas luftës ne jemi dëshmitar të numrit shumë të madhë të vrasjeve të pasluftës duke larë hesapet e tyre personale që kanë ngelur nga e kaluara.³⁷

Për shkak të shkatrimeve dhe pamundësis për të siguruar egzistencën e tyre njerëzit janë të detyruar për tu zhytur në kriminalitet kjo edhe më tej e përkeqëson gjendjen në shoqëri pasi që çdo kush lufton vetëm e vetëm për egzistenc e tyre dhe të familjeve të tyre dhe në këtë kohë kriminaliteti është në rritje të vazhdueshme ku si aktivitete më të shpeshta kriminale në kohë pas luftës dhe konflikteve të armatosura janë vjedhjet, vjedhjet e imta, trafiqe ilegale përfshirë edhe tregëti me lëndë narkotike, armë, kontraband me mallra të ligjshëm, tregëti me njerëz dhe shumë aktivitete tjera kriminale.

Ne ishim dëshmitarë të konfliktit të armatosur në shtetin tonë dhe pasojat janë prezent edhe sot e kësaj dite ku ende shoqëria është e ndarë në baza etnike dhe egziston mungesa e jo tolerancës mes grupeve etnike që jetojnë brenda një shteti, madje janë edhe fqinjë mes tyre. Në shtetin tonë fatkeqësisht si rezultat i konfliktit të armatosur sot ende nuk po arrihet që të harmonizohen të drejta dhe interesat e shoqëris.

Këto dhe shumë pasoj tjera janë prezente në shoqërin tonë për shkak të konflikteve dhe mos tolerancës etnike. Ngecja ekonomike, mungesa e vendeve të reja të punës, largimi i të rinjve nga shteti dhe shumë pasoj tjera po shohim sot pas 20 vitesh nga konflikti i cili po na ndjek edhe pas shumë vitesh.³⁸

³⁷ Halili.R, Disa krime dhe shkaqet e tyre në Kosovë në fazën e pasluftës, Vjetari-Buletini nr1/2000, Prishtinë faq, 49-57

³⁸ Janev I, Legal Aspects of the Use of a Provisional Name for Macedonia in the United Nations System, AJIL, Vol. 93. no 1. 1999.

5.2. Përndjekjet politike

Përndjekjet politike janë ato që shumë shpesh shkaktojnë pasoja në popuj të tërë me veprimet e tyre të pa kontrolluar dhe tendencioze. Si shembuj më flagrant ne mund të cekim përndjekjet që janë bërë ndaj shqiptarëve në kohra të ndryshme dhe arsyeja kryesore ka qenë sepse ata kanë menduar ndryshe politikisht nga qarqet politike të pushtetit. Edhe sot e kësaj dite ene nuk janë dëmshpërblyer të përndjekurit politik nga ana e shtetit tonë, madje edhe sot vazhdon në një form tjetër e modernizuar e ndjekjes dhe pamundësimit të realizimit të ideve dhe aspiratave politik të shqiptarëve në shtet.

Përndjekjet politike nuk janë prezente vetëm në shtetin tonë por edhe në shtetet tjera dhe këtë të dhënë e vërteton numri i viktimave të pa numërta në rajone në botë si në Palestinë, Liban, Çeçeni, Ruand, Avganistan dhe shumë shtete të tjera në të cilat po viktimizohen qenjet njerëzore si mos me qenë asgjë.

Po ashtu tek përndjekjet politike pushtetarët e shfrytëzojnë pushtetin për të nënshtruar palën kundërshtare edhe kjo krijon revolt tek pala e cila është në pozitë të nënshtruar dhe fillon reagimi kundër tyre dhe automatikisht fillon konflikti mes palëve të ndryshme ku këto konflikte përfundojnë me pasoja goxha të mëdha ku numri i të vrarëve për shkak të përndjekjes është shumë i lartë.

Në shtetin tonë egzistojnë shoqata të tilla të cilat luftojnë për të drejtat e tyre dhe për personat të cilët kanë qenë të persekutuar në aspektin politik, ku njëra nga këto shoqata e ka paditur shtetin për mos kompenzimimin e duhur të personave të përndjekur pra siç shohim ende edhe sot egzistojnë probleme të kësaj natyre dhe shteti nuk reagon si duhet apo edhe nuk reagon fare në këtë drejtim pasi që pushtetarët e kanë kapur shtetin dhe është e pa mundur reagimi i organeve kompetente për të reaguar ndaj fenomeneve të tilla.³⁹

³⁹ <https://portalb.mk/33138-shoqata-e-te-perndjekurve-padit-maqedonine-ne-strasburg/>

6. Faktorët mikrogrupor

Faktotët mikrogrupor kanë ndikim në kryerjen e sjelljeve devijante përfshir këtu edhe vrasjet e kualifikuara kjo për arsye se familja, shoqëri dhe shkollimi janë faktor me ndikim relevant në shfaqjen e kriminalitetit në shoqëri. Këtu nuk duhet haruar se ndikimi i këtyre faktorëve po shfaqet kohëve të fundit në masë shumë të madhe duke parë se shoqëria ka filluar ta humbas rolin e saj, sot shumë pak njerëzit interesohen për njëri tjetrin për hallet, problemet e njëri tjetrit, nevojat për ndihma janë të shumta por ndryshimet që po paraqiten në jetë sidomos jeta e shpejt dhe dinamike ka bërë që njerëzit ti harojn madje të afërmit e tyre.

Gjithashtu edhe familja tani më është më e vogël në aspektin e antarëve të familjes që jetojn së bashku, mardhënia e punës e të dy bashkëshortëve ka bërë që fëmijët janë lënë pas dore nga aspekti i përkujdesjes prindërore, mungesa e tyre një pjesë të madhe të kohës është po ashtu edhe një faktor brenda saj që ndikon ndjeshëm se si fëmijët e kalojn kohë e lirë me kë shoqërohen, sa arrin të marin diturit në shkolla dhe si e përjetojn ata mungesën e prindërve.

6.1. Familja dhe rrethanat familjare

Familja paraqet bërthamën kryesore të shoqëris në qoft se familja është në harmoni automatikisht edhe shoqëria është në harmoni dhe e kundërta familje të degraduara nënkupton edhe shoqëri të degraduar dhe të shkatruar. Familja është baza kryesore në të cilën fëmijët marin njohurit e para lidhur me sjelljet që duhet ti bëjnë apo mos ti bëjnë, çfar është e drejt dhe çfar nuk është e drejt.

Pra familja luan shumë role në formimin e brezave të ri, si roli edukativo-arsimor, roli parandalues, ekonomik, mbrojtës dhe funksione tjera të ngjajshme. Me rëndësi është të cekim se secili rol apo funksion që e luan familja ka ndikim direkt tek antarët tjer të familjes dhe pasojat shfaqen pas kalimit të viteve. Roli edukativ është parësor pasi që nëpërmjet edukimit adekuat nga familja brezat e rinjë do të jene të dobishëm për veten por edhe për shoqërin e tyre. Tek roli parandalues i familjes shihet qart se si familja është një faktor determinues në parandalimin e kriminalitetit në shoqëri dhe kjo realizohet duke i këshilluar dhe duke i edukuar fëmijët se si duhet të sillen, të dallojn të mirën nga e keqja. Pra familja paraqet urëlidhëse mes të rinjëve dhe shoqëris, pra hapat e par drejt rrethit shoqëror fëmijët i marin në bashkpunim me familjet e tyre dhe tani të paramednojm një situat të tillë në të cilën prindërit e fëmijëve kanë kontakte me botën e kimit dhe meren me aktivitete të jashtëligjshme kuptohet se

kontaktet e para të tyre me botën e jashtëme do të jene shokët dhe miqët e prindërve që nënkupton se çfar shoqëri kan prindërit në një farë mënyre u imponohet edhe të rinjëve duke u shoqëruar me individ të botës së erët kriminale. Dhe e kundërta në rast se familja është e ngritur e arsimuar dhe me perspektiv atëher me pa dyshim që edhe fëmijët do të kenë një të ardhme larg kimit. Ky është një supozim pasi që fëmijët shpesh edhe gjatë kohës sa janë jashtë familje ata mund pa njohuri të prindërve të shoqërohen me individ delikuent dhe ata shpesh ndikohen nga sjelljet e tyre dhe bijen pre e aktiviteteve të cilat nuk janë kriminale si për shembull ikja nga shkolla, bredhja, lypsarai, pastaj kalojn në vjedhje të imta, vjedhje në xhepa, vjedhje në markete të ndryshme dhe faktikish ata të rinjë po fillojn të krijojn karier kriminale.⁴⁰

Në literatur familjet me probleme janë ndarë në disa grupe edhe atë në familje të degraduara, familje të mangëta, familje me shumë antarë, familje që janë zhytur në kriminalitet.

Tek familjet e degraduara problemet nuk kanë të ndalur dhe pasojat fatkeqësisht i përjetojn fëmijët ata i vuajn më keq degradimin e familjes. Fëmijët janë prezent gjatë dhunës që ushtrohet në familje, aktivitetet tjera kriminale dhe të kundërligjshme si prostitucioni, narkomania, alkoolizmi, prezenca e armëve të ndryshme në shtëpi dhe shumë forma tjera shkaktojn psoja dhe trauma që në ta ardhmen shfaqin të rinjtë që janë ritur në kësi lloj rrethanash jetësore.

Familjet e mangëta janë ato familje që jetojn me një prindër, ku njëri prind ka vdekur, ose ka braktisur familjen, gjendet në mërgim, apo edhe në burg dhe këtu egziston një hapsir e madhe të cilën vështir se mund ta mbuloj njëri prind dhe fëmijët që arrin moshën më madhore duke e vuajtur këtë gjendje fillojn të ndërmeren me aktivitete kriminale ku jo rall here përfundojn edhe me kryerjen e vrasjes. Po ashtu edhe tek familjet me shumë antarë problemet janë prezente pasi që tek këto familje vështir se mund të kete kujdes të mjaftueshëm tek fëmijët dhe shpesh ata ndihen të vetmuar nuk mund që problemte e tyre që ti paraqesën tek prindërit dhe shpesh zgjedhjet e tyre janë të rezikshme dhe me pasoja për to. Pra me një fjal familja ndikon ndjeshëm tek parandalimi i kriminalitetit mirëpo nuk duhet që ta marim si fakt i kryer se vetëm familjet me probleme “prodhojnë” kriminalitet pasi që edhe tek familjet me një standard të lart dhe status shumë të mirë në shoqëri edhe ata zhyten në kriminalitet madje ata shpesh kryejn krime që shkaktojn psoja shumë të thella për shoqërin.⁴¹

⁴⁰ Latifi.V & Elezi.I & Hysi.V,Politika e luftimit të kriminalitetit,Prishtinë,2012, faq.281

⁴¹ Hysi.V,Kriminologjia, Botimi dytë i përmisuar, Tiranë, 2010, faq.365-366

6.2. Shkolla dhe ambienti shkollor

Edukim dhe shkollimi është arma më e mirë për të luftuar të keqen dhe paditurinë por fatkeqësisht sot në kohën tonë ngadal po tretet vlera e shkollimit dhe vet arsimimit. Pasojat sot nuk duken por me kalimin e viteve do të shfaqen me siguri. Në shoqërin tonë shllolla po shfaqet problematike jo në aspektin institucional por nxënësit edhe studentët e kanë humbur kuptimin dhe rëndësin e edukimit, ata thjesht e shohin shkollën si zbatim për të kaluar kohën, për të krijuar miqësi të reja, madje disa prej tyre e shohin si obligim si diçka të detyrueshme që duhet të kryehet dhe asgjë më tepër. Këtë fakt e vërteton edhe gjendja e testimit PISA ku në vitin 2000 ishte shumë më mirë në krahasim me vitin 2015.⁴²

Është me rëndësi të cekim se shkollimi adekuat me profesor dhe arsimtar në nivel të lartë do të ndikonte ndjeshëm në përmisimin e nivelit të arsimimit por problemet që shfaqen në shkoll dhe ambijentet shkollore shpesh e tejkalojn edhe arsimtarin, ku në këto ambijente paraqiten ngacmime mes nxënësve, bullizmi, keqtrajtme për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike dhe shumë forma tjera të nënçmimit të fëmijëve të kësaj kategorije. Duke qenë të ekspozuar në këto rrethana ata shpesh mundohen vet që ti zgjidhin problemet e tyre me metodat e tyre duke u përleshur apo edhe më e keqja duke marë sende të forta nga shtëpia duke i përdorur si armë për të sulmuar bashkëmoshatarët e tyre.

Duke patur dobësi në vet sistemin e arsimimit kushtet jo adekuate në shkolla, mgacmimet e ndryshme kjo jep mundësi që fëmijët të meren fillimisht me dukuri asociale si ikja nga mësimi, bredhja, pastaj marja me aktivitete kriminale si vjedhje, thyerje dhe dëmtime të objektit të shkollës, shoqërimi me individ të cilët meren me aktivitet kriminale, trafiqet ilegale të lëndëve narkotike dhe shumë forma të tjera të aktiviteteve kriminale.

Jo vetëm individët me munges arsimimi janë të pranishëm në aktivitete kriminale, shpesh individ që kanë shkollim të lartë janë prezent në krimin e organizuar dhe kjo e hudhë posht tezën se personat e pa arsimuar janë më të prirur të kryejn krime.

Në shtete evropiane theks i veçant është kushtuar reformimit dhe avancimit të shkollave dhe institucioneve tjera edukativ-arsimor me qëllim që nga moshat e hershme të arrihet që të

⁴² <http://www.mon.gov.mk/index.php/AL/2014-07-23-14-03-25/vesti-i-nastani-alb/2356-pisa-2018>

krijohet vese të mira, përgaditja për jetë të pavarur, të jenë të suksesshëm dhe nëpërmjet kësaj të arrihet të parandalohet kriminaliteti në tërësi si e keqe e madhe që i kanoset shoqëris.⁴³

6.3. Mjedisi që na rrethonë

Ndikim të rëndësishëm në shfaqjen dhe rritjen e numrit të kriminalitetit apo edhe parandalimin e saj ka edhe shoqëri. Kjo për vet faktin se shoqëri e shëndosh nënkupton shoqëri në të cilën njerëzit janë të sigurt, të barabart, trajtohen me kujdes dhe ndihmojnë njëri tjetrin në çdo kohë. Mjedisi i vrazhd në të cilin për çdo ditë ka vrasje, vjedhje, trafikë të kundërligjshme individët të cilët nuk arrijnë që të largohen dhe të sigurojnë jetë të mirë për veten dhe familjet e tyre ato bëhen pre e kriminalitetit. Në qoftë se familja dhe shkolla janë në nivel të duhur por rrethi i personave me të cilët shoqërohmi janë delikuent ato shpesh tërheqin nga vetja edhe “kriminel të rinjë”. Është e pakontestueshme fakti që kushtet e vështira të banimit, familje të degraduar, shkollim jo adekuat apo edhe braktisja në tërësi e shkollimit janë faktor të cilët bashkërisht ndikojnë në krijimin e kriminelëve potenciale.

Në shoqërinë tonë shpesh si të marginalizuar janë romët të cilët edhe janë të prirur të kryejnë aktivitete të jashtëligjshme kjo për vet faktin se shoqëria i etiketon nuk ju mundëson punësim adekuat në abazë të shkollimit të tyre, diskriminohen në çdo sferë të jetës së tyre dhe për këtë shkak ata duhet që të mbijetojnë në këtë shoqëri të egër e cila nuk i jep aspak rrugdalje nga gjendja e mjerushme, dhe ata duke u munduar që të krijojnë egzistencë për vetë bijen pre e viktimizimit dhe kryerjes së krimineve të ndryshme ku më shpesh janë prezent te lypçaria, bredhja dhe vjedhjet e imta apo edhe vjedhjet nëpër xhepa. Por në rastin e kundërt nëse shoqëri u ndihmon çdo kujt pa marrë parasyshë dallimet që egzistojnë në shoqëri gjendja do të ishte shumë më adekuate për të gjithë pjesëtarët e shoqëris.⁴⁴

Shoqëria me aktivitete e saj dhe sjelljet drejtuar pjesëtarëve të saj mundëson ose të parandalohet kriminalitet në shoqëri ose të rritet numri i kriminalitetit pra një rol shumë të madh e luan edhe vet shoqëri dhe fajtori nuk duhet kërkuar larg nesh por brenda nesh që të arrihet që të ulët kriminaliteti dhe krijimi i kushteve stabile për jetesë për çdo person pa dallime.

⁴³ Hysi.V, Kriminologjia, Botimi dytë i përmisuar, Tiranë,2010, faq.367-368

⁴⁴ <https://mk.ambafrance.org/Permiresimi-i-gjendjes-se-romeve-ne-Maqedoni>

7. Faktorët sociopatologjik

Faktorët sociopatologjik apo siç njihen edhe si sëmundjet patologjike shoqërore kanë sjell pasoja goxha të mëdha në shfaqjen e kriminalitetit. Termi sëmundje nuk nënkupton sëmundje në aspektin shëndetësor për në aspektin moral dhe njerëzor, i kanë quajtur sëmundje shoqërore pasi që individët po që se fillojnë të meren me këto aktivitete dhe e kanë të vështirë që të largohen nga to, njejt si sëmundjet që vështirë kurohen dhe kërkojnë mund dhe përkushtim. Si faktor sociopatologjik që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit përfshirë këtu edhe vrasjet e kualifikuara janë alkoolizmi, bixhozi, narkomania, prostitucionai, bredhja, lypsaria dhe shumë aktivitete të ngjajshme të cilat sjellin pasoja direkte tek individit në fillim dhe më vonë shfaqen edhe pasojat tek shoqëria.

7.1. Alkoolizmi

Alkoolizmi si dukuri sociopatologjike ka ndikim të dukshëm në shfaqjen e kriminalitetit në përgjithësi dhe vrasjeve në veçanti. Alkoolizmi është dukuri që është prezente shpesh në shoqërinë tonë kjo për vet faktin se individët mendojnë se nëpërmjet alkoolizmit do të largohen problemet të përditshme dhe do të gjejnë rehati por përkundrazi ata në gjendjen e alkoolizuar shkaktojnë shumë dëme. Fillimisht pasojat e përdorimit të tepërt të alkoolit i ndejnë antarët e familjes ku personi në gjendje të tillë shpesh përdorën dhunë ndaj tyre, kur ngelet pa para ata vjedhin nga shtëpia për të siguruar pije për vete. Nëpërmjet veprimeve të tyre ata e shkatrojnë ekonominë e familjes së tyre, shpesh nga gjendjet e tyre ata humbin edhe të afërmit e tyre dhe kur nuk kanë çka të marrin nga shtëpia e tyre atëherë ata fillojnë të kryejnë vjedhje vetëm e vetëm të sigurojnë para për blerjen e alkoolit. Individët në gjendje të tillë shpesh gjenden edhe para konflikteve me persona të ndryshëm, përleshën rrugëve dhe në këto situata ata edhe kryejnë vrasje pa mos qenë në vetëdije të plot për veprimet e tyre. Përveç pasojave në aspektin moral dhe material, këta individë kanë edhe pasoja në shëndetin e tyre ku gjendja e tyre shëndetësore është e shkatëruar, janë shumë të dobët fizikisht, shfaqet haresa, amnezia dhe përkeqësimi i disa funksioneve psikike.

Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë në botë ka rreth 140 milion alkoolikë. Në Republikën e Maqedonisë ka 40-60 mijë alkoolikë, apo 2-3% të popullatës janë alkoolikë. 80% nga prodhimi i rrushit dhe pemëve përpunohen në alkool. Në Republikën e Maqedonisë alkooli merr pjesë me 12% si faktor për fatkeqësi, rëndë të lënduar dhe vdekje gjatë

fatkeqësive. Etil alkooli është i përfaqësuar prej 3-7% në birra, 6-14% në verë, 30-50% në liker, 16-55% në raki dhe 45-50% në konjak⁴⁵

7.2. Narkomania

Narkomania paraqet dukuri negative shoqërore e cila manifestohet me konsumimin e lëndëve narkotike dhe produkteve të ndryshme të lëndëve narkotike të cilat japin reaksione të ndryshme tek personat të cilët i konsumojn ato. Konsumimi i këtyre lëndëve narkotike bënë që personi të bëhet i varur nga to dhe pasojat shfaqen fillimisht në shëndetin e tij e pastaj edhe në shoqëri në tërësi. Individët të cilët konsumojn lënd narkotike janë me shëndet të dobët, të zbehtë në fytyrë, nuk mund ti kontrollojn veprimet e tyre, lehtë manipulohen, shumë shpejt zhyten në aktivitete kriminale vetëm për të siguruar lënd narkotike për konsumin e tyre personal.

Këta individ në fillim i harxhojn të ardhurat e familjeve të tyre madje duke shitur çdo gjë që kanë në pronësi dhe posedim të vetin, kur nuk kanë çfar të shesin tjetër atëher fillojn të meren me kriminalitet si vjedhje, vjedhje të imta, pjesmarje në përleshje fizike, janë në gjendje të kryejnë çfar do lloj pune të pisët vetëm që të arrijn tek doza e drogës të cilën duhet ta konsumojn.⁴⁶

Nga të dhënat në literatur shumë autor konsiderojn se viktim e narkomanis janë shtresat e ulta që nuk kanë të ardhura dhe zhyten në aktivitete kriminale, por në realitet si konsumues të lëndëve narkotike janë shtresat e lart të shoqëris personat e pasur, madje edhe liderët politik konsumojn lënd narkotike të cilat i stimulojn që të jenë në gjendje që të flasin me orë të tëra para qytetarëve pa mos u lodhur dhe pas mos pushuar aspak. Nga të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësis miliona njerëz janë konsumues të lëndëve narkotike kur përqindja më e lart është tek shtetet me standart të lart ekonomike.

Shumë narkoman meren edhe me aktivitete tjera kriminale si shpërndarja e drogave dehëse, nxitjen e të rinjëve në konsumimin e saj, shitblerjen e armëve, tregëti me njerëz, prostitucion, reketim, kidnapim të fëmijëve me qëllime të shantazhimit dhe shumë aktivitete tjera që janë të ndërlidhura me kriminalitetin dhe pasoja janë stratosferike në shoqëri. Ku miliona dollar po hudhen posht për ndjekjen dhe kapjen e trafikantëve të lëndëve narkotike.

⁴⁵ <http://ckrm.org.mk/dokuments/alkoholizam%20al.pdf>

⁴⁶ Halili.R, Aspektet juridike dhe kriminologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë, Përparimi, nr,2, Prishtinë, 1984, faq.177-178

Ditëve të fundit jemi dëshmitar se edhe nështetin tonë janë kapur sasi të mëdha të lëndëve narkotike dhe kjo tregon se edhe ne jemi të rrezikuar nga këto aktivitetet kriminale dhe pasojat e tyre.⁴⁷

7.3. Prostitucioni

Prostitucioni si dukur sociopatologjike është shumë e vjetër madje ka autor të cilët mendojnë se ajo është e vjetër edhe sa vet njerëzimi. Disa autor të tjerë e konsiderojn edhe si profesion, ku thuhet se është njëri ndër profesionet më të vjetra që njih historia e njerëzimit. Sot në botën bashkohore është përhapur me të madhe kjo dukuri negative e cila shkakton pasoja dhe çrregullime të mëdha në shoqëri dhe prishjen e ekuilibrave dhe raporteve mes gjinive në përgjithësi. Në disa shtete perendimore kjo dukuri është e legalizuar dhe ushtrohet si profesion, si formë e mardhënies së punës me kushte të përcaktuara paraprakisht. Shpesh mendohet se prostitucioni është mjeshtëri apo zanat që ushtrohet për të siguruar të ardhura për egzistencë pra mendohet se kjo dukuri sociopatologjike kryhet si profesion por në të kaluarën kanë egzistuar edhe forma të ndryshme të manifestimit si prostitucion ritual, religjioz, substitucional dhe në fund prostitucio kompensacional. Tek prostitucioni ritual mardhëniet janë kryerë në kohë të caktuar pra në formë të ritualit dhe kjo formë njihet si forma më e vjetër e prostitucionit. Tek prostitucioni religjioz është lloji i prostitucionit i cili është kryer në tempuj fetar, pra femrat të cilat kanë shërbyer në tempuj kanë ofruar edhe mardhënie seksuale. Prostitucioni substitucional është lloji i çrregullimeve të mardhënieve seksuale të femrave për shkak të mardhënieve të çregulluara seksuale. Ky lloji i prostitucionet kryehet edhe në rastet kur bashkëshortja ka mungesë e burrit një kohë të gjatë dhe për këtë shkak kryhen mardhënie me qëllim të kompenzimit të mungesës dhe çrregullimet në mardhënie.⁴⁸

Personat që meren me aktivitete të tilla shpesh janë të detyruar për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, mungesës së punës, jetës së vështirë, më së shumti femrat bijen pre e viktimizimit të këti lloji të kriminaliteti. Nga të dhënat në literatur femrat janë viktimizuar për shkak të gjendjes së vështirë, papunësis, mashtrimet e ndryshme nëpër agjensione e ndryshme të bukuris, lidhje të shpejta të dashurisë dhe shumë forma të tjera të viktimizimit. Në rast se ato

⁴⁷ <https://ëëë.tetovasot.com/2019/08/situatë-dramatike-droga-ka-vershuar-tetoven-cdo-dite-kapen-te-rinj-me-marihuane-dhe-kokaine/>

⁴⁸ Halili.R, Disa karakteristike kriminologjike dhe viktimologjike të trafikimit të femrave, E drejta nr.1-4, Prishtinë, 2000, faq.35-36

mundohe që të rezistojn ose vriten ose dhunohen me forc dhe kërcënohen që të mos i paraqesën rastet në polici. Kjo dukuri është prezente edhe në shtetin tonë sidomos në kryeqytet ku funksionon dukëshëm kjo dukuri por edhe në qytete tjera është prezente kjo dukuri negative ku shpesh klubet e natës apo edhe shtëpit private shfrytëzohen si hotele për të realizuar këtë veprimtari. Nga anketa e realizua 35% të personave të pyetur janë kundër prostitucionit ndërsa vetëm 12% kanë theksuar se është formë e mir për të fituar para apo të ardhura. Është për të ardhur keq se si trajtohen femrat të cilat sillen nga jasht shtetit apo edhe ato që janë vendase duke u shkelur të gjitha të drejtat njerëzore.⁴⁹

7.4. Bixhozi

Bixhozi apo siç njihet ndryshe edhe si lojë hazardë apo lojë e fati. Në këto lloj lojrash fati personat vendosi shuma të mëdha parash dhe duke parashikuar se çfar do të ndodhë lidhur me lojën që ata e parashikojn. Është interesante se personat që i pëlqejn këto lojra mendojn se me pak punë dhe me një investim të vogël do të fitojn shuma të mëdha të parave. Fillimisht individët e provojn si formë e hobit apo zbavitje dhe pastaj duke i llogaritur humbjet e mëdhaja ata edhe më shumë zhyten në bixhoz. Personat të cilët organizojn bixhozin janë persona me karrier kriminale dhe përveç bixhozit ata meren edhe me krime tjera si prostitucioni, tregëti armësh, trafikë të lëndëve narkotike dhe krime të tjera që përfshin edhe vrasjet e ndryshme, kidnapimin e fëmijëve të personave me ndikim në shtet për ti shantazhuar. Në bazë të dhënave miliona njerëz meren me bixhoz ku qarkullimet janë maramendëse për pronarët e tyre.

Aspektet negative të bixhozit në fillim shfaqen vetëm tek individi dhe familja e tij por edhe më vonë pasojat shfaqen në shoqëri ku në shtetin tonë në çdo cep janë të hapura lojra të fatit të cilat janë shumë afër shkollave dhe pasojat shfaqen edhe tek të miturit ku ata shpesh i frekuentojn këto vende. Format më të shpeshta të bixhozit janë lidhja me kusht, garat e kuajve, qenëve, ndeshjeve të futbollit, basketbollit, boksit, tenisit. Lojrat tek automatët, llotaria, ruleti, tombolla dhe shumë forma të tjera të lojrave të fatit. Nga vet emërtimi këto janë lojra të fatit dhe nëse fati është nga ana jote mundësit janë për të fituar diçka.

⁴⁹ <https://skopjeinfo.mk/prostitucija-vo-skopje-zgodni-devojki-se-prodavaat-na-site-strani>

Në shtete të ndryshme për ti parandaluar pasojat e bixhozit që janë të lidhura me kriminalitetin janë parapar rregulla strikete se në çfar largësie duhet të jenë të hapura, kush ka të drejt të luaj dhe rregulla tjera të ndërlidhura me këtë kategori. Në shtetet fqinje si Shqipëria dhe Kosova këto lojra të fatit janë mbyllur dhe mundësia për të luajtur është kufizuar në masë të madhe duke parandaluar që të miturit të bijen pre e saj por edhe personat e rritur. Tek shteti jonë ende nuk janë ndërmar masa të nevojshme në këtë drejtim për të mbrojtuar qytetarët nga kjo dukuri sociopatologjike edhe pse ka pasur disa protesta për këtë qëllim por fatkeqësisht nuk kanë qenë të miftueshme që një here e përgjithmon të rregullohet kjo çështje.⁵⁰

⁵⁰ <https://mia.mk/levizja-anti-bixhoz-dyshon-se-do-te-ndryshoje-ligji-per-lojerat-e-fatit/?lang=sq>

8. Faktorët e brendshëm

Faktorët e brendshëm luaj një rol shumë të rëndësishëm në shfaqjen e kriminaliteti edhe pse ne ndoshta nuk arrim që ti vërejm me sy por ato janë prezent dhe ndikojn në masë të madhe. Faktorët e brendshëm njihen edhe si faktor subjektiv pra që kanë lidhje të drejtpërdrejt me individin, me zhvillimin e tij që nga fëmijëria e deri në ditën e kryerjes së krimit po ashtu ndikojn edhe pas ngjarjes kriminale. Autor të ndryshëm e çmojnë shumë rëndësinë e faktorëve subjektiv duke parë edhe realisht ndikimin e tyre tek individit dhe shpesh në studime të ndryshme shkencore vërtetohet se rëndësia e faktorëve subjektiv është e madhe por nuk janë kryekput vetëm këto faktor të cilët ndikojn në shfaqjen e kriminalitetit pasi që në qoftë se do të bazoheshim vetëm në faktorët subjektiv do të ishte jo e sakt për vet faktin se numri dhe llojlojshmëria e faktorëve që ndikojn në shfaqjen e kriminalitetit përfshirë këtu edhe vrasjet e kualifikuara është shumë i madhë. Në kapitujt më lart është cekur edhe rëndësia e faktorëve tjer që ndikojn në shfaqjen e kriminalitetit, por edhe në rast se nuk i marim si më pak të rëndësishme atëher përsëri do të gabonim në vlerësimin tonë dhe për këtë shkak duhet që të hulumtohen të gjithë faktorët në mënyrë të detajuar që të arrihet në një konkluzion të sakt dhe të bazuar në fakte.

Është me rëndësi të ceket se në shtetin tonë shumë pak studime janë bërë në drejtim të faktorëve subjektiv ku në disa raste të veprave penale si faktor determinues paraqiten edhe ana subjektive e cila ka rëndësi për zbardhjen e rasteve të krimit.

8.1. Personaliteti

Gordon Allport e përkufizon personalitetin si organizim dinamik të atyre sistemeve psikofizike të individit të cilët caktojnë cilësitë e tij, mënyrën e adaptimit në rrethin ku jeton. Personalitetin e njeriut e përbëjnë dy komponenta ajo psikike dhe biologjike. Tek komponenta psikike bëjnë pjesë karakteri, temperamentit, motive, shprehjet, emocionet, inteligjenca, qëndrimet e tij, kujtesa, bindjet, idealet. Tek aspekti i bindjeve dhe idealeve përcaktojnë kahje që do të ai personalitet, përcaktojnë se çfarë do, pikësynimet e tij.

Njohja e vetive të personalitetit të njeriut ka rëndësi të veçantë për të kuptuar psikologjinë e personit pasi që vetit ndikojn dukshëm në vet personin por edhe në vetit tjera të personalitetit. Personaliteti i njeriut lidhet drejtpërdrejt me jetën të cilën jeton personi që bartë atë personalitet, me rrethanat shoqërore, në një shoqëri të ngritur dhe të zhvilluar është më e lehtë që të krijohet një personalitet i drejt dhe i frytshëm për shoqërinë. Pra personaliteti nuk është

veti e lindur apo e trashëguar por është diçka e cila zhvillohet dhe ritet së bashku me vet personin që e bart personalitetin. Pra gjatë procesit jetësor individi duke dashur që të njihet me botën dhe që ti përshtatet zhvillimit me qëllim që ti kënaq nevojat e veta ai ndryshon në vetvete dhe ky ndryshim lidhet me personalitetin e tij që po krijon në proces e sipër.

Personaliteti i personi kalon në katër faza në fazën e fëmijërisë, e rinisë, pjekurisë, dhe pleqërisë. Në zhvillimin e personaliteti të duhur fazat e para si ajo e fëmijërisë ka ndikim të veçant në formimin e personalitetit ku raporti familjar, edukimi, arsimimi janë faktorë jetik që ndikojnë në formimin e personalitetit. Këtu është me rëndësi të cekim edhe hapat e parë në procesin e arsimimit, krijimi i shoqëris së re, pedagog të aftë që arrin që ti përcojnë njohurit e tyre tek fëmijët, ambijet i përshtatshëm shkollor, vlersimi i duhur nga shoqëri janë evidente për rëndësin e tyre në personalitetin e një fëmije që është në ndërtim e sipër. Tek faza e dytë e rinis këtu është faza më delikate fazë kjo e cila në qoftë se nuk është në përputhje me rregullat morale dhe ligjore atëher e gjithë puna e realizuar në fazën paraprake do të bije posht dhe do të jetë e pa vler. Në këtë fazë shpesh të rinjtë dinë të rebelohen nuk dëgjojnë askënd vepron në kokë të tyre dhe pasojat shfaqen dhe i japin një kahje tjetër personaliteti të tyre, kjo kahje mund të jetë ose positive ose negative por ë të shumtën e rasteve është negative.

Tek faza e pjekurisë është faza më e gjatë në të cilën personi duhet të sjell disa vendim shumë të rëndësishme për veten të cilat kanë të bëjnë me profesioni e tyre, krijimin e familjes, bartjen e përgjegjësisë dhe kuptimin e seriozitetit të jetës. Dhe në fund është faza e pleqëris e cila karakterizohet me personalitet stabil dhe të qetë, tek të moshuarit aktivitete fizike bien ndjeshëm kurse ato psikike janë të njëjta dhe kjo është factor që ata mbyllen në vetvete, distancohen nga rrethi për shkak se ata e ndjejn veten të pa rëndësishëm për shoqërin. Nuk duhet haruar se në zhvillimin e personaliteti ndikon edhe zhvillimet historike, doket, traditat e ndryshme, zhvillimet në shoqëri në përgjithësi.⁵¹

Nga elaborimi i më sipër mund të arrim në një konkluzion të tillë që personaliteti është faktor shumë i rëndësishëm në shfaqjen e kriminalitetit duke patur parasysh edhe faktotër tjer që ndikojn brenda për brenda. Nga studimet kriminologjike si kryerës më të shpesht të krimeve janë personat që kanë përjetuar trauma të ndryshme gjatë zhvillimit të personalitetit të tyre dhe kjo ndikon ndjeshëm në kriminalizimin e tyre. Është fakt i pakontestueshëm se traumat e ndryshme që përjetojnë në jetë lënë gjurmë të pa shlyeshme tek individët dhe ato i ndjekin

⁵¹ Rot.N,Psikologjia e përgjithshme, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1990, faq.230-231

deri në fund të jetës dhe ata më lehtë meren me aktivitete kriminale se sa të bëjnë një jetë të rehatshme dhe të ndershme. Pra jeta e kaluar nëpër vuajtje dhe stërmundime pa dyshim se ndikon në personalitetin e një personi.

8.2. Karakteri

Karakteri paraqet vetin kryesore të personalitetit të individit. Madje shpesh karakteri identifikohet me nocionin e personalitetit. Pra me termin karakter nënkuptojmë vetitë që tregojnë qëndrimet e individit ndaj disa parimeve, vlerave, normave dhe rregullave morale të ambientit që e rrethojnë atë. Shpesh në literaturë ne dëgjojmë shprehje të tipit që një individ është stabil dhe ka karakter të fort ose edhe e kundërta një individ është jo stabil, nuk ka karakter të fort për të bërë ballë problemeve në jetën e përditshme. Po çfarë nënkupton me termin karakter stabil, është ai lloji karakteri që personat e kanë si veti të tyre dhe ata gjithmonë reagojnë kundër padrejtësive, flasin të vërtetën, ndihmojnë të tjerët, janë altruist, i shmangen problemeve të pa nevojshme dhe shumë veti të tjera pozitive që e përbëjnë personin me karakter të fort ose stabil.⁵² Ndërsa e kundërta është me personin i cili ka karakter të ulët ose jo stabil këto individë më shpesh bëjnë pre e krimeve dhe njëkohësisht kryejnë krime të ndryshme për shkak të karakterit të tyre, por cilat janë këto cilësi që e përbëjnë karakterin jo stabil, ato janë gënjeshtria, mungesa e respektit për të tjerët, pavendosshmëria për probleme të caktuara, luftimi me të vërtetën, konsumimi i alkoolit pa masë, konsumimi i lëndëve narkotike, bledhja dhe shumë sjellje të tjera devijante dhe asociale që i karakterizojnë ato.

Pra siç e cekim më lart personat me karakter stabil është shumë e vështirë që të kryejnë vepra penale për shkak të vetive të tyre në karakterin e tyre në përgjithësi por edhe këta individë në disa raste të caktuara mund të kryejnë krime siç është rasti i prekjes së nderit të tyre apo prejka në setër ku edhe ata me karakter të fort nuk mund të rezistojnë padrejtësisë që u është bërë dhe ndërmarin veprime të këndërligjshme, rast tjetër është edhe hakmarrja si dukuri negative e cila i ka përcjellur shqiptarët brez pas brezi ku individët me karakter të fort për shkak të shtypjeve dhe presioneve të ndryshme nga rrethi detyrohen që të hakmerren ndaj personit i cili u ka shkaktuar dëmin në fjalë.

Ndërsa tek individët me karakter jo stabil ata shumë lehtë kryejnë krime për shkak të vetive të tyre në personalitet dhe karakter ku me mashtimet dhe pabesitë e tyre shpesh duhet që të

⁵² Hoti.A, Psikologjia e personalitetit, Tiranë, 2012, faq.88

zgjedhin rrugë të vëzhtir për tu shmangur problemeve që ballafaqohen për çdo ditë për shkak të jo stabilitetit të tyre. Dhe për atë shkak është shumë e ndvojshme që gjatë analizimit të veprave penale që janë kryer të analizohen edhe shkaqet që i kanë shkaktuar ato përfshirë këtu edhe personalitetin si veti kryesore e strukturës psiqike të individit.⁵³

⁵³ Nushi.P, Psikologjia, Prishtinë, 1996, faq.212-214

8.3. Temperamenti

Temperamenti paraqet në veti me rëndësi të veçant të personalitetit ku nëpërmjet temperamentit shihen reagimet e personit ndaj ngacmimeve të jashtme, temperamenti nuk tregon vetëm mënyrën e reagimit emocional por edhe shpejtësin, fuqinë dhe qëndrueshmërin e reagimit ndaj ngacimeve të jashtme. Në literature përmende disa tipe të temperamentit. Më posht do të elaborojm katë tipat të temperamentit edhe atë: kolerik, sanguinik, flegmatik dhe melankolik.

Temperamenti kolerik manifestohet me ndjenja intensive, individi në këtë temperament zemërohet shumë shpesh dhe shpejt, dhe si rrjedhim krijon konflikte me të tjerët. Reagimet e tyre janë të fuqishme dhe të vullshme, por janë ambiciozë, punojnë me pasion dhe intensitet, janë të shoqërueshëm. Personat kolerik nuk janë sa duhet stabilë, cilësohen me emocione të vullshme dhe shpejt e ndrojnë disponimin. Për shkak të këtyre vetive këta individ janë të shtyrë që të kryejn veprime të kundërligjshme siomos kur egzistojn edhe shtypje të jashtme nga ana e rrethit ku ata jetojnë dhe përjetojnë trauma të rënda në këtë drejtim dhe shumë lehtë pastaj manipulohen dhe kryejn krime.⁵⁴

Temperamenti sanguinik i përket tipit të personi i cili reagon shpejt dhe me vull por emocionet e tyre nuk janë shumë të fuqishme dhe nuk zgjatin shumë. Po ashtu edhe këta persona lehtë e ndrojnë disponimin nga të gëzueshëm në të hidhëruar. Në popull ky lloj personi njihet si gjaknxehtë dhe për këtë arsye ata shpesh kryejn krime nën afëkt për shkak se nuk arrijn që ta kontrollojnë veten në situata të caktuara dhe bëjnë pre e ngacmimeve të jashtme.

Temperamenti flegmatik është lloji i temperamentit ku personi i cili e posedon këtë lloj të personalitetit reagon ngadal ndaj ndikimeve dhe shumë rrallë shqetësohet dhe emocionet nuk manifestohen apo vështirë manifestohen. Për këtë lloj temperamentit është karakteristike qetësia, stabiliteti nuk ndikohet nga ngacimet e jashtme dhe nuk vepron pa mos u menduar për veprimet e veta. Tek ky lloj i temperamentit personat krimet i kryejn me paramendi dhe një shkallë të lartë të përgjegjësis dhe është e veçantë të theksohet se këta individ rrallëherë paraqiten si recedivistë të kriminalitetit.

Temperamenti melankolik është prezent tek tipat e personave që janë të qetë dhe të mbyllur në vetvete, ata në jetën e përditshme shumë lehtë fyhen nga ngacimet e jashtme dhe shumë

⁵⁴ Rot.N, Psikologjia e personalitetit, Prishtinë, 1968, faq.64-65

rëndë i përjetojn situatat e caktuara, vuajtjet dhe përjetimet tek këta persona lënë shumë pasoja në ndërgjegjen e tyre.

Gjendja e tyre e çrregulluar dhe nën afetk zgjat një kohë të gjatë dhe shpesh ato qëndrojnë me ditë të tëra në këtë gjendje të dëshprimit. Ata problemet e përditshme i zmadhojnë dhe i konsiderojnë si problem të mëdhaja që nuk kanë zgjidhje për këta individë, shpesh këta individë janë të përirur që të kryejnë vetvrasje, përveç vetvrasjes ata kryejnë krime edhe nga xhelozia e tepruar sidomos xhelozia në dashuri, në mësim, në punë dhe në të gjithë proceset jetësore që i rrethojnë ata. Nga praktika e gjykatave hasen shpesh individë që kryejnë vrasje nga xhelozia e madhe dhe hakmarrja ndaj të tjerëve.⁵⁵

8.4. Shprehitë

Shprehitë janë veti subjektive të cilat luajnë rol në sjelljet e personit përfshirë këtu edhe sjelljet kriminale. Shprehitë krijohen nën ndikimin e vazhdueshëm të edukatës, raporteve shoqërore, kulturore dhe familjare. Pra shprehitë nuk janë të lindura por ato fitohen me kalimin e viteve dhe jetës së personit, si për shembull personat gjatë procesit të arsimimit, aktiviteteve të lira, leximi i librave dhe shumë mënyra tjera ata kultivojnë shprehitë të mira. Përveç shprehive të mira në jetë personat janë të ekspozuar edhe ndikimeve negative dhe që ato ndikojnë në krijimin e shprehive negative që ndikojnë në shfaqjen e kriminalitetit. Si shprehitë negative tek të rinjtë paraqitet edhe ikja nga shkolla, shoqërimi me delikuent, bixhozi që na moshat e reja, bredhajt, lypsaria dhe me kalimin e viteve ato shëndrohen në shprehitë kriminale si vjedhjet, vjedhjet e imta, trafiket ilegale, vjedhjet e makinave dhe shumë krime të tjera. Sot në kohën moderne është paraqitur edhe kriminaliteti kompjuterik si rezultat i shprehive të këqija që të rinjtë i krijojnë gjatë jetës së tyre.

Është fakt i pa kontestueshëm se në rast se individët gjatë jetës së tyre meren me aktivitete frytdhënëse, në shkollë përgaditen në mënyrë adekuate për jetë, janë në gjendje që ta dallojnë të mirën nga e keqja ata do jenë të gatshëm për një të ardhme më të sigurt për vetë dhe për tërë shoqërinë.

Kultivimi i shprehive të mira nënkupton edhe një shoqëri më të sigurt dhe perspektiv për të ardhmen por nekëtu mund të cekim edhe shprehitë negative të cilat janë shkaktar që paraqiten

⁵⁵ Halili.R, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, faq.342-343

krimet sidomos tek krimet që kryhen për shkak të shprehive si dhe tek recedisistët. Pra studimi dhe analizimi në tërësi i shprehive dhe faktroëve tjerë është i rëndësis së veçant për vet faktin se me zbulimin e faktorëve që shtyn në paraqitjen e kriminalitetit dhe trajtimin e këtyre faktorëve do të arriheshte në mënyrë efikase në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit.⁵⁶

8.5. Emocionet

Emocionet janë ato që e shoqërojnë njeriun në çdo cep të jetës së tij edhe pse ai mundohet që të veprojë në mënyrë racionale përsëri ndikohet nga emocionet pa varësisht se sa mundohet ai që të shmangët ndikimit të tyre. Në grupin e emocioneve hynë gëzimi, pikllimi, urrejtje, frikë, rënkim, mlllef, urrejtje, kënaqësi, lemeri, mallëngjim dhe shumë emocione të tjera që ndikojnë në shfaqjen e veprimeve kriminale. Në bazë të psikologjisë emocionet ndahen në dy grupe emocione elementare dhe emocionet komplekse, emocionet elementare janë procese apo ndryshime psikike më të thjeshta ndërsa emocionet komplekse janë procese më të komplikuar ato paraqesin ndryshime dhe përjetime psikike më të komplikuar dhe më të thella. Emocionet janë veti psikike të cilat mund të trashëgohen nga paraardhësit por ato mund të fitohen edhe gjatë procesit të mësuarit dhe formimit të individit gjatë zhvillimit të tij jetësor.

Emocionet si veti psikike të individit shpesh ndikojnë në shfaqjen e kriminalitetit për arsye se këta persona përjetojnë një gjendje të vështirë shpirtërore dhe traumat e ndryshme të cilat i kanë përjetuar gjatë jetës së tyre ndikojnë në gjendjen e tyre shpirtërore dhe stabilitetin e tyre në raport me rrethin ku ata jetojnë. Është e pa kontestueshme se kjo gjendje e tyre duke menduar se ata janë të pa rëndësishëm dhe të pa vlerë, të përjashtuar nga shoqëria, mungesa e inkuadrimin të tyre në shoqëri e zmadhon edhe më tej problemin e tyre dhe këto rrethana hapin rrugë në kryerjen e krimeve të ndryshme si për shembull vrasjet nga xhelozia, hakmarrja ndaj personave që i konsiderojnë si armiq në imagjinatën e tyre.⁵⁷

Nga praktika gjyqësore e vendeve evropiane është vërejtur se personat që kanë probleme me kontrollimin e emocioneve të tyre që shpejt nervozohen, pikëllohen, gëzohen paraqiten si kryerës të veprave penale nga ndikimi i këtyre gjendjeve shpirtërore të tyre. Këto gjendje njihen si gjendje afekti dhe personi kryen veprime të pa kontrolluara atypëraty pa mos i llogaritur pasojat e veprimit të tij dhe kjo është edhe një tregues tjetër për rëndësinë e emocioneve dhe ndikimin e tyre në dukurit kriminale sidomos tek krimet të cilat kryhen nën gjendjen e afektit dhe ndikimit të emocioneve. Nga praktika janë prezente rastet e vrasjeve nga dashuria e madhe

⁵⁶ Rot.N, Psikologjia e personalitetit, Prishtinë, 1968, faq.130

⁵⁷ Milutinovic.M, Kriminologjia, Prishtinë, 1982, Botimi shqip, faq.467

kjo shpjegohet si çrregullim i personit i cili nuk është në gjendje që ti kontrolloj veprimet e tija dhe privon nga jeta personat që i do më së shumti.

8.6. Motivet

Motivet po ashtu hynë në grupin e cilësive dhe vetive të personalitetit të njeriut, ato janë fuqi shtytëse që e shtynë një individ që të jetë aktiv dhe që të lëviz përpara. Motivet përbëhen nga vetëdija dhe vullnetit si elemente përbërëse të motivit dhe të gjithë proceset jetësore që realizohen në jetën e njeriut janë të shtyra nga motivet pra të gjithë veprimet janë të motivuara. Edhe veprimet kriminale si sjellje që kryehen në bazë të vetëdijes dhe vullnetit të individit janë të shtyra nga motivet e bredëshme të cilat i shtynë individin që të arrij që të kryej aktivitete kriminale dhe të kundërligjshme.

Edhe motivet janë të ndara dhe të klasifikuara në dy grupe si motive biologjike dhe sociale apo autor të tjerë i ndaj edhe si motive të lindura dhe motive të fituara në jetë.

Motivet biologjike janë ato motive të lindura të cilat personi i fiton nga momenti i lindjes dhe ato e shoqërojnë atë gjatë gjithë jetës së tyre ku si motive biologjike mund të cekim motivi për ushqim, për shuarjen e etjes, për mardhënie intime, motivi për pushim, për gjumë, motive për të larguar dhimbjen dhe shumë motive të tjera që janë të natyrës biologjike dhe që janë të pamangëshme dhe këto motive i posedojn edhe gjallesat tjera por njeriu këto motive i ndryshon dhe i modifikon me kalimin e viteve dhe nën ndikimin e zhvillimit të tij gjatë procesit të arsimimit, edukimit dhe transformimit të shoqëris në përgjithësi. Pra këto motive janë në formë edhe të instiktit që njeriu mundohet që ti realizoj. Sjelljet kriminale që kryhen për shkak të motiveve biologjike janë ato krime që kanë të bëjnë me mos kontrollimin e dëshirave dhe instikteve të brendëshme nga personi ku si krime më të shpeshta paraqiten krimet seksuale, ose krimet nga qëllimet materiale.

Tek motivet sociale apo motivet e fituara nga jeta dallojnë nga ato biologjik pasi që këto formohen gjatë procesit jetësor të individit dhe ndikimeve të jashtme në jetën e tyre dhe nevojave dhe kërkesave që ata dëshirojnë që ti përmbushin në jetën e tyre. Si motive sociale mund të përmendim motivin për shoqërim, motivin për vetëpohim, motivi agresivitetit, motivi i sigurisë, frikës, motivi i përfitimit dhe shumë motive të tjera që janë prezent tek njerzit e ndryshëm. Motivi për shoqërim është i rëndësi së veçantë për vet faktin se njeriu si qenie sociale ka nevojë që të shoqërohet që të ketë miq me anë të së cilëve do të ndaj të mirat dhe të këqijat, lidhja e tij me botën e jashtëme është e domosdoshme dhe frytdhënëse në rast se ajo

shfrytëzohet pozitivisht por në rast se ajo devijon nga kontesti normal atëher paraqiten pasoja me devijie kriminale ku shpesh personat imitojn dhe kryejn veprime devijante si rezultat i shoqërimit me njerëz të gabuar.⁵⁸

Motivi për vetëpohim është një motiv po ashtu i rëndësishëm dhe me vler ku personat kanë dëshir që të arrijn vlersim dhe afirmim në shoqëri dhe në rrethin ku ata jetojn ku afirmim është prezent në shumë fusha si në fushën e dituris, pasuris, pozitive të ndyrshme publike dhe këshut me radhë. Kjo fuqi shtytëse e brendëshme është e lidhur edhe me dëshirën për pushtet të individit dhe këtu paraqitetn problemet jo vetëm se personi ka dëshir që të jetë më i pasur apo më i ditur se të tjerët por problemi qëndron në rastin kur ai nuk arrin që ta realizoj këtë dëshir dhe aspirat të tijën atëher shfaqen problemet reale për vet personin por edhe për shoqërin në tërësi. Që të mund që ti mbulojn dështimet e tyre individët shpesh futen në botën e kriminit si form më të lehtë për të arritur suksesin e munguar të tyre dhe pasojat janë katastrofale për të dhe për shoqërin.

Motivi i sigurisë është po ashtu një shtytje e madhe dhe fuqi e brendëshme e cila e shtyn individid që të krijoj dhe të ruaj një gjendje të caktuar rehatije dhe sigurie qoft kjo materiale apo edhe jo materiale. Individët me këto veprime duke u munduar që të sigurojn veten ata bëjnë shkelje të drejtave të tjerëve dhe kjo menjëher hynë në zonën kriminale, madje egzistojn raste nga praktika ku tek individët paraqiten trauma që kinse dikush po i rezikon ata dhe sigurin e tyre dhe duke u munduar që të mbrohen nga këto persona imagjativ ata kryejn krime.

Motive tjera që kanë rëndësi në shfaqjen e dukurive kriminale përfshirë këtu edhe vrsjet e kaulifikuara janë motivi i agresivitetit dhe motivi material apo pasuror këto dy motive janë shtytës të brendshëm që ndikojn në shfaqjen e dukurive kriminale për vet faktin se njeriu si qenie njerëzore gjithmon shfaqën agresivitet në momentet kur nuk arin që ti zgjedh problemet e cakuara të cilat e tangojn në jetën e përditëshme po ashtu ai është në çdo kohë në luft me të tjerët që të arrij që të krijoj mirqenie ekonomike dhe të ardhura sa më të larta dhe momenti kur ky plan nuk funksionon atëher hynë në funksion ana e erët e tij që ato qëllime ti realizoj me çdo kusht pa mos llogaritur pasojat e veprimeve të tij. Individët tjerë që nuk i arrijn qëllimet e tyre në jetë shpesh e motivojn veten e tyre edhe më shumë që të punojn në të ardhme që ti korigojn gabimet e tyre dhe të arrijn rezultatet e planifikuara por jo të gjithë mendojn njejt dhe

⁵⁸ Sigmund.F, Qëndresa dhe shtypja-zhvillimi i libidos dhe organizimi seksual, Tiranë-1997, faq.45-47

për këtë shkak ato e shohin zgjidhjen te aktivitetet kriminale për të arritur qëllimet e tyre pa shumë vështirësi.⁵⁹

8.7. Inteligjenca

Intelegjenca paraqet element me rëndësi të madhe në personalitetin e njeriut, në psikologji intelegjenca përkufizohet si aftësi e të menduarit, zgjedhjes së problemeve dhe orientimit të situatave të ndryshme në jetën e përditshme. Alfred Binet, një psikolog francez, e ka përkufizuar mençurinë si tërësia e ecurive mendore lidhur me përshtatjen ndaj mjedisit.⁶⁰

Inteligjenca ka ndikim të jashtzakonshëm në veprimet e njeriut madje thuhet se nga niveli i intelegjencës varen edhe kushtet e jeës së individëve, madje inteligjenca ka ndikim edhe në sjelljet kriminale të njerëzive pasi që shkalla e ulët e intelegjencës është faktor që njerëzit të bijen më lehtë për të aktivitetet kriminale. Kjo e dhënë bazohet në faktin se individët që kryejn krime shpesh nga testet e realizuara janë me një shkallë të ulët të intelegjencës por kjo nuk mund të merret si fakt i kryer për arsye se në kohët e fundit si kryerës të krimeve po paraqiten edhe individ me shkallë të lartë të intelegjencës dhe me shkollim të lartë siç është rasti me kriminalitetin e jakave të bardha, ku ky lloj i kriminalitetit nuk mund të kryhet nga ana e personave me intelegjencë më të ulët pasi që këto lloj krimesh kërkojnë njohuri më specifike dhe më të komplikuar për kryerjen e tyre. Është fakt se inteligjenca ndikojnë në kriminalitet por shkalla e intelegjencës i kategorizon edhe llojet e krimeve që kryehen ku individët me shkallë më të lartë të intelegjencës kryejn krime më të komplikuar si falsifikimi i dokumentave, sulmet kibernetike, kriminaliteti i organizuar dhe shumë forma tjera të përparuara të kriminit që individët me intelegjencë të ulët vështirë se mund të kryejn dhe e kundërta tek personat me intelegjencë të ulët ata janë prezent te krimet ordinere si vrasjet, vjedhjet, plaçkitjet, vjedhjet e imta, pjesmarje në rahje dhe krime të ngjajshme të kësaj natyre. Po ashtu është me rëndësi të cekim se personat me intelegjencë të ulët në shumicën e rasteve paraqiten si kryerës direkt të krimeve kurse personat me inteligjenca të lartë paraqiten si organizator apo porositës të tyre.

Pra nga hulumtimet e bëra mund të arrihet në një përfundim se si kryerës të krimeve paraqiten si personat me shkallë të lartë të intelegjencës edhe ato me shkallë të ulët të saj por dallimi qëndron në llojin e krimeve, në mënyrën e kryerjes, mjetet e kryerjes dhe kështu me radhë, por

⁵⁹ Shtino.Nazim, & Piliko.A, Personaliteti dhe çrregullimet e tij, Tiranë, 2001, faq.130-134

⁶⁰ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Inteligjenca>

me rëndësi për ne është që të analizohen dhe të hulumtohen në detaje ndikimet e faktorëve që lidhen me intelegjencën në shfaqjen e kriminalitetit për parandalimin e të njëjtit.⁶¹

8.8.Çrregullimet mendore

Çrregullimet mendore janë factor që ndikojn në aktivitetet e njerëzive në përditëshmëri dhe çrregullimet e natyrave të ndryshme ndikojn dukshëm në disharmonin e veprimeve të tyre dhe kërkesave të shoqëris dhe rrethit ku ata jetojn. Kohëve të fundit është dhënë rëndësi e veçant çrregullimeve që paraqiten tek individët për arsye se ata nuk janë në gjendje që ti kuptojn rëndësin e veprimeve të tyre, ata shkaktojn pasoja serioze në shoqëri dhe jo vetëm për shoqëirin por edhe për familjet e tyre. Nevoja e hulumtimit të gjendjeve të tyre paraqitet në momentin e kryerjes së veprave penale por është e nevojshme që kto hulumtime dhe analiza tek këta individ të bëhen para se ata të kryejn veprime delikuate sepse dihet se për ta nuk mund të shqiptohet dënim me burg për shkak të gjendjes së tyre shpirtërore por është e nevojshme që ata të trajtohen në entet përkatëse për ruajtje dhe shërimin e tyre. Çrregullimet mendore janë të kategorizuara në disa grupe edhe atë neuroza, psikoza dhe psikopatitë.

Neurozat janë çrregullime të lehta që janë prezente si në popullësin delikuate edhe në atë jo delikuate ky është një fakt që jo të gjithë personat me probleme janë kryerës të krimeve. Termi neuroze përfshin një grup të gjërë të çrregullimeve më shenja dhe simptoma të ndryshme. Personi i cili vuan nga ky çrregullim nuk e humbën komplet kontaktin me rrethin dhe shoqërin ata i mbajnë edhe më tej kontaktet me rrethin por pamundësia e zgjedhjes së problemeve shfaqen tek këta persona konfliktet të brendëshme që vështri se mund ti tejkaloj personi vetëm pa ndihmën e personave kompetent.⁶²

Pra zhvillimet e shpejta në teknologji, industri dhe shumë sfera të jetës i sollën problem të reja njeriut modern dhe këto probleme shfaqen në çrregullime të lehta si frika, pasiguria dhe probleme të ngjajshme. Shpesh për shkak të gjendjes që gjenden ata kryejn edhe krime si sulme seksuale dhe veprime të turpshme, pastaj paraqiten edhe kleptomanët dhe piromanët.

Tek neurozat është e njohur në literaturën kriminologjike histeria si ngarkes e veçant emocionale ku individët që janë në këtë gjendje janë të prirur që të japin deklarata të rejshe pastaj denoncime të rejshe, tek gjinia femërore është prezente denoncimi i rejsëm për

⁶¹ Milutinoviq.M, Kriminologjia, Prishtinë, 1982, Botimishqip, faq.463-464

⁶² <https://www.psikologjiadheshendeti.com/neurozat/>

dhunime dhe përndjekje ndaj tyre. Tek këta persona egziston problem të brendëshme dhe çrregullime të jetës seksuale dhe bëjnë denoncime të rejshme.

Po ashtu tek tipat hysterik është prezente edhe xhelozia e madhe ndaj të tjerëve po asnjë arsye konkrete, po ashtu ata viktimizohen që të marrin vëmendjen e rrethit dhe shoqëris dhe realizimit të qëllimeve të tyre absurde.

Psikozat janë po ashtu çrregullime mendore të cilat ndikjon në veprimet e personave të cilët vuajn nga ato dhe shpesh për shkak të këtyre çrregullimeve ato kryejn edhe vepra penale.

Fjala psikozë përdoret për të përshkruar faktorët që prekin mendjen, ku paraqiten disa humbje të kontaktit me realitetin. Kur dikush sëmuret në këtë mënyrë quhet episod psikotik, gjatë kësaj gjendje personat e kanë të vështirë që të dallojnë realitetin nga iluzionet që u shfaqen atyre për shkak të gjendjes në të cilën janë. Pra psikoza është çrregullim i rëndë shpirtëror ku këto çrregullime mund të jenë të përkohëshme apo të përhershme dhe dhe në terme mjeksore njihen edhe si dementia. Ne mund të përmendim disa lloje të psikozave si shizofrenia, paranoja, epilepsia etj.

Shizofrenia është një çrregullim mendor që paraqitet shpesh në praktikën gjyqësore dhe fjala shizofreni është nga gjuha greko-latine që nënkupton shizo-përçarje, disharmoni dhe frenos shpirt që në përkthim të lir nënkuptojn një jetë të shkarë shpirtërore. Tek personat shizofren paraqiten ide, halucinacione, iluzione të çuditshme që nuk egzistojn në realitet pra kemi çrregullime të botës shpirtërore, munges të kontrollimit të emocioneve dhe ata mendojnë se janë të dërguar nga perëndia që të kryejn misione të caktuara. Ata vuajn nga mania se dikush i ndjek apo dëshiron që tu bëjë keq atyre dhe shpesh në këtë gjendje kryejn krime në vetmbrojtje po që në realitet nuk egzistojn sulmues të vërtet apo persona që i përndjekin për ti vrarë.⁶³

Paranoja paraqiten si kompleks i sëmundjeve mentale që rrjedhimisht kanë ndikim në shfaqjen e kriminalitetit. Paranojakët vuajn nga këto çrregullime dhe shpesh mënyra e të menduarit dhe të pamurit e realiteti është shumë më ndryshe nga personat tjerë që janë normal, këta persona e konsiderojn vetën si shpikës të ideve të ndryshme si inovator, shpesh në praktikën kriminologjike hasen raste të individëve që akuzojn institucione të ndryshme kinse ato u kanë vjedhur shpikjet e tyre, barnat apo ilaçet që ata kanë zbuluar. Përshkak të çrregullimeve mendore ata vuajn edhe nga xhelozia, smira dhe kryejn krime me pretes se personat tjerë po i

⁶³ <https://ëëë.nimh.nih.gov/health/topics/schizophrenia/raise/raise-questions-and-ansëers.shtml#1>

marin zbulimet e tyre, vrasja e bashkëshortëve nga xhelozia madhe dhe krijimi i ide se po tradhtohen dhe duhet që ta pastrojnë nderin e tyre janë po ashtu si forma të shpeshta të krimeve. Epilepsia po ashtu është një çrregullim me ndikim të madhë në sjelljet kriminale sidomos në rastet kur te personat që vuajn nga këto çrregullime paraqiten sulmet epileptike dhe ata e kanë shumë të vështirë që të kontrollojnë veten e tyre. Më karakteristik janë krimet që janë kundër jetës dhe trupit, vjedhjet, dhunimet pjesmarja në rahje dhe shumë forma të tjera të krimeve.

Psikopatitë janë po ashtu çrregullime mendore dhe shpirtërore po në krahasim me psikozat janë më të lehta. Nga vet emërtimi psiko që nënkupton shpirt dhe patos vuajtje ato i përkufizojm si vuajtje shpirtërore që në literature hynë në grupin e çrregullimeve të përkohëshme apo kalimtare. Persona që vuajn nga këto çrregullime hasen shpesh në praktikën gjyqësore dhe këto individ janë të prirur që të kryejn krime nga xhelozia, vrasje nga hakmarrja, piromania dhe vepra tjera penale për shkak të disharmonis së brendëshme që i karakterizon ato. Për këta persona thuhet që kanë munges respekti të vlerave në rrethin dhe shoqërin ku ata jetojnë dhe për atë shkak ata kryejn veprime dhe sjellje jomorale, shpifje, akuza të pa baza, dhunime seksuale.⁶⁴

Ne mund të arrijm në një konkluzion të till që çrregullimet shpirtërore janë ato që ndikojn ndjeshëm në shfaqjen e veprimeve të pa matura dhe të pa kontrolluara të personave që vuajn nga këto sëmundje dhe shpesh ata duke mos i kontrolluar veprimet e tyre ata kryej edhe krime dhe veprime tjera delikvente, këtu nuk duhet haruar edhe fakti se gjendja e tyre është me rëndësi në momentin kur do të paraqiten para gjykatës për përgjegjësin e tyre penale të tyre ku edhe kodi penal i RMV-së parasheh që për këta persona nuk mund të dënohen me dënime me burg për shkak të gjendjes së tyre dhe se nuk i kuptojn rëndësin e veprimeve të tyre dhe për këtë shkak është e nevojshme kujdesi dhe vendosja në ente përkatëse për këtë individ që të trajtohen por me këtë veprim mborhet shoqëria nga dëmet e tyre dhe një kohësisht edhe familja ku ata jetojnë pasi që ata u shkaktojnë problem edhe të afërmit të tyre. Për ne me rëndësi është që të studiohet se si këtë çrregullime ndikojn në shfaqjen e sjelljeve delikvente dhe sa është ndikimi i tyre si faktor kriminogjen në shoqëri që të arihet një tretman adekuat që të minimizohen pasojat nga veprimet e tyre të pa përgjegjshme.

⁶⁴ Shtino.N & Piliko.A, Personaliteti dhe çrregullimet e tij, Tiranë, 2001, faq.90-92

Kapitulli III

Masat parandaluese në luftimin e vrasjeve të kualifikuara

1. Aspekte të përgjithshme lidhur me parandalimin

Parandalimi është çështja më komplekse tek kriminaliteti dhe sidomos tek vrasjet e kualifikuara ku si element kualifikues paraqitet një numër i madhë i rrethanave të cilat ndikojnë në konsiderimin e një veprë penale të rëndomt dhe të kualifikuar. Njohja e këtyre rrethanave që ndikjon në shfaqjen e këtyre veprave penale është një përparësi e madhe për politikën e luftimit të kriminalitetit pasi që me njohjen e tyre do të mund që sa më lehtë të intervenohet në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në shoqëri.

Masat parandaluese janë tërësia e veprimeve që ndërmeren nga ana e subjekteve shoqërore dhe shtetërore ku si qëllim kryesor kanë parandalimin dhe pengimin e shfaqjes së dukurimeve kriminale duke përfshirë edhe vrasjet e kualifikuara si vepra penale që shkaktojnë pasoja të rënda në shoqëri.

Masat e luftimit të kriminalitetit ndahen në dy grupe në masat preventive dhe represive të luftimit të kriminalitetit që kanë qëllim parësor mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti dhe risocializimin e kryerësve të veprave penale. Këto masa të cekura më lart janë masat me karakter të brendshëm apo masat që ndërmeren nga ana e shtetit në territorin e vet që ndërmeren për parandalimin e kriminalitetit.⁶⁵

Është e pa kontestueshme vlera dhe rëndësia e masave në uljen e dukurive kriminale në shoqëri por edhe kur dështojnë të njëjtat atëherë hynë në funksion masat represive të cilat zbatohen në momentin kur personi kryen veprë penale dhe duhet të vuajë për shkeljen e ligjit pozitiv. Nuk duhet haruar se masat kanë qëllim luftimin e kriminalitetit, mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti dhe risocializimin e kryerësve të krimeve dhe që në të ardhmen të mos kryejnë krime të tjera dhe jo hakmarrjen ndaj tyre për veprat e kryera.

⁶⁵ Milutinović, M., Politika kriminale, Prishtinë, 1985, faq.7-10

2. Aspekti preventiv në parandalimin e vrasjeve të kualifikuara

Siç e cekta edhe në faqen paraprake preventiva është tërësia e veprimeve që ndërmeren nga ana e subjekteve shoqërore me qëllim të parandalimit dhe pengimit të kriminalitetit në shoqëri. Masat parandaluese ndahen në masa të përgjithshme dhe të posaçme, masat e përgjithshme janë ato masa që ndërmarin subjektet shoqërore dhe shtetërore në luftimin e kriminalitetit në shoqëri, ndërsa në masa të posaçme janë masat që ndërmeren nga ana e organeve të judikaturës dhe subjekteve shtetërore me qëllim shmangien e aktiviteteve kriminale në shoqëri

Sa do të jenë të suksesshme aspektet preventive kjo varet edhe nga bashkpunimi i shoqëris dhe gaditshmëria për bashkpunim në luftimin e kriminalitetit që po frikson në masë të madhe çdo pjestar të shoqëris, ku nga të dhënat statistikore në krye të listës frika më e madhe është nga lufta, pastaj krimi dhe në fund është frika nga vdekja.

Nëse bëjm një shikim retrospektiv nga e kaluara si masa për luftimin e krimit kanë qenë masat e dhunshme si dënimet trupor, torturat, dëbimet nga shoqëria dhe fisi mirpo sot këto masa janë të pa vlefshme për vet faktin se këto masa më janë larguar nga legjislacionet penale të shteteve të ndryshme dhe për atë shkak është shfaqur nevoja që të paraqiten masa të reja në luftimin e krimit në shoqëri dhe si masa të karakterit preventive mund të përmendim shumë prej tyre si shkolla, familja, punësimi, standardi i lart jetësor, mjetet e komunikimit masiv qoft të shkruara qoft ato elektronike dhe shumë masa tjera me karakter preventiv.⁶⁶

2.1. Shkollimi dhe arsimimi

Shkollimi dhe arsimimi si faktor në ngritjen e një populli në përvetësimin e njohurive të reja në bazë të së cilave të rinjtë do ti fitojn gjatë procesit të arsimimit ndikon drejtpërdrejt në shoqëri në parandalimin e dukurive kriminale dhe prandalimin e të njëjtave.

Është e rëndësis së veçant që gjatë procesit të edukimit dhe arsimimit brezat e rinjë të mësohen për pasojat që shkakton kriminaliteti dhe të kenë mundësi që të vizitojn entet penitensiare në shtetin tonë që kjo sa do pak të ndikoj edhe tek ata që të jenë sa më të kujdesshëm me veprimet e tyre në të ardhmen.

⁶⁶ Latifi.V & Elezi.I & Hysi.V, Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë, 2012, faq.25-28

Po ashtu është me rëndësi të veçantë që brezat e rinjë të kenë lëndë të veçanta gjatë procesit të arsimimit që të arrijnë nga afër të njoftohen me nocionet, termet e ndryshme lidhur me kriminalitetin, pastaj me aktivitetet kriminale dhe pasojat që ata shkaktojnë në shoqëri dhe ndëshkimin që u shqiptohet individëve që nuk i respektojnë rregullat dhe ligjet e përcaktuara nga ana e organeve kompetente në shtet.

Përfitimi i këtyre njohurive bazë për kriminalitetin dhe dukurit kriminale në moshë të reja do të mundësonte që të rinjtë të jenë më të kujdesshëm në të ardhmen pra në këtë formë realizohet preventiva gjenerale me përgaditjen e të rinjëve për jetë pa kriminalitet dhe dukuri kriminale. Është e pa kontestueshme vlera dhe rëndësia e shkollimit tek të rinjtë pasi që në shkollë fillojnë aktivitete e para patologjike dhe në rast se nuk ndërmeren aktivitete në trajtimin dhe dhënien e ndihmës tek këta të rinjë ata më vonë do të fillojnë të meren edhe me aktivitete kriminale të rrezikshme për shoqërinë.⁶⁷

Në botën bashkohore shkollat arrijnë që të luajnë një rol konstruktiv në parandalimin e kriminalitetit me edukimin adekuat të brezave të rinjë por mund të ndodhë edhe e kundërta kur mungesa e procesit të duhur të edukimit dhe problemeve që shfaqen gjatë procesit të edukimit dhe arsimimit këto rrethanë të ndikojnë dukshëm në shfaqjen e dukurive patologjike të para tek të rinjtë dhe më vonë këta të rinjë shëndrohen në kriminel potencial dhe me rrezikshmëri të lartë për shoqërinë ku ata gjenden dhe jetojnë.

⁶⁷ Hysi.V, Kriminologjia, Botimi dytë i përmisuar, Tiranë, 2010, faq.367

2.2. Mjetet e komunikimit masiv

Zhvillimet që po zhvillohen në shoqëri me hapa gjigand janë të rëndësish se veçant për shoqërin për vet faktin se ato po mundësojnë që informatat të arrijn nga njëri cep i botës në tjetrin dhe kjo është një lehtësim i jetës për njeriun modern, por nga ana tjetër shpesh mjetet e komunikimit po keqpërdoren dhe orientojn një shoqëri të tërë në një drejtim që ata e shohin si të arsyeshme për përfitimet e tyre materiale. Pra mungon një censur në atë se çfarë po shfaqin para publikut dhe sa ato informata janë të vërtetuara dhe të besueshme për publikun.

Në shtetin tonë nëse flasim për mjetet e komunikimit dhe lirin e fjalës është për të ardhur keq se media të ndryshme janë nën ndikimin e pushtetarëve dhe pasojat janë prezente me shfaqjen e informatave të pa sakta dhe jotë besueshme dhe gjithëmon programet e tyre janë drejtura në favor të subjekteve që janë në pushtet dhe ne kemi qenë dëshmitar se si mediat përdoren në garën politike dhe hakmarrjet politike mes subjekteve të ndryshme.

Duke mos mjaftuar kjo ata në programet e tyre informative por edhe zbavitëse po shfaqin programe degraduese, ku shpesh kryerja e krimeve të ndryshme në shoqëri shfaqet me pompozitet të jashtëzakonshëm dhe kjo ndikon negativisht tek opinioni publik ku si publik paraqiten edhe personat e mitur të cilët shumë lehtë ndikohen nga shfaqjet skandaloze që paraqiten nëpër media të ndryshme. Po ashtu edhe programet zbavitëse nuk japin asnjë mesazh edukues për opinionin publik që po i ndjek për çdo ditë, qëllimi i vetëm i tyre fatkeqësisht është përfitimi i të ardhurave sa më të larta pa marrë parasysh se çfarë po i servohet publikut.

Është e pa kontestueshme mungesa e vlerave që shfaqen në emisionet televizive por edhe në veprat e ndryshme, botime, arti, shkencë po shfaqin mungesë profesionalizmi dhe njëkohësisht po shiten antivlerat publikut dhe jo ato që kanë rëndësi në parandalimin dhe luftimin e krimit.

Pra rëndësia e mjeteve të komunikimit është shumë e madhe dhe këtë rëndësi duhet që ta shfrytëzojmë në si shoqëri në favorin tonë me emisione me karakter informative por edhe ato zbavitëse, botimin e veprave shkencore me vlerë për shoqërinë, filmave dhe gjithë industrisë së komunikimit në parandalimin e kriminalitetit përfshirë këtu edhe vrasje e kualifikuara.⁶⁸

⁶⁸ <https://empoëer-journalist.citizens-channel.com/kolapsi-i-industrise-kreative-dhe-fati-i-gazetareve-te-rinj/>

2.3. Zhvillimi ekonomik

Zhvillimi ekonomike si një faktor shumë i rëndësishëm për parandalimin e kriminalitetit në shoqëri, duke patur parasysh pasojat e mëdha që shkakton në aspektin ekonomik ku në shtete të ndryshme harxhohen miliona dollar për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit si për shembull luftimin me krimin e organizuar, trafikun me narkotik, terrorizmin dhe shumë forma tjera të krimit që shkakton pasoja direkte në shoqëri por edhe në vet shtetin në të cilin janë prezent këto dukuri kriminale.

Mungesa e mekanizmave adekuat në luftimin e kriminalitetit, ekonomit e shkatruara janë si element shtes në pamundësimin e luftimit të kriminalitetit dhe mbrojtjen e shoqëris nga ai. Nëse ne bëjm një krahasim mes shteteve në tranzicion ku bënë pjes edhe shteti ynë dhe shteteve me ekonomi të zhvilluara ku përqindja e papunësis është shumë e ulët, standardi i lart jetësor japin një pasqyr të qart se ekonomia dhe zhvillimi i duhur i saj pamundëson në masë të madhe në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit në shoqëri, kjo nuk nënkupton se kriminalitetit është zhdukur në tërësi por ndjeshëm është ulur rreziku nga kriminaliteti, po ashtu në shtetet skandinave po mbyllen dita ditës burgjet dhe kjo tregon se ato shtete po ndërmarin hapat e duhur në drejtim të luftimit të kriminalitetit dhe ato masa që ata i kanë marë po dalin shumë frytdhënëse.

Fatkeqësisht në shtetin tonë shkalla e papunësis është shumë e lart, mungesa e stabilitetit ekonomik, korrupsioni i madh janë shkaktar që qytetarët shpesh për shkak të pamundësive të tyre që ti zgjedhin problemet me të cilët përballen çdo ditë ata zhyten në aktivitete kriminale pa dëshirën e tyre dhe kjo është si rezultat i faktorëve të lart përmendura. Po ashtu edhe ata që janë të punësuar kanë paga të ulta që me vështirësi po mbijetojn dhe kjo tregon qart që faktorët ekonomik kanë ndikim të dukëshëm në shfaqjen e kriminalitetit në shoqëri dhe për atë shkak duhet që të ndërmeren masa serioze në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit me masa adekuate ekonomike dhe jo me populizëm siç është bërë deri më sot nga njerëzit e pushtetit.⁶⁹

Rritja e pagave, punësimi në bazë të meritokracis, luftimi i korrupsionit, standardi më i mir jetësor do të ishin disa nga rekomandimet tona për luftimin dhe parandalimin në mënyrë adekuate krimin dhe sidomos vrasjet e kualifikuara.

⁶⁹ Latifi.V & Elezi.I & Hysi.V, Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë, 2012, faq30-38

3. Lufta represive ndaj kriminalitetit

Duke patur parasysh se shpesh masat preventive nuk arrin që të kenë rezultatet e nevojshme në parandalimin e krimit atëher hynë në funksion masat represive të cilat po ashtu kanë qëllimin e njëjtë në luftimin e krimit por me shqiptim e masave ndëshkimore drejtuar kryerësve të krimeve.

Për luftimin më të suksesshëm të veprës penale vrasje e kualifikuar nevojitet anazil dhe shqyrtim adekuat të metodave kriminologjike për njohjen e shkaqeve dhe rrethanave që favorizojn shfaqjen e këtyre veprave penale. Pra njohja e shkaqeve do të mundësonte që fillimisht të njihen aspektete shkencore të krimit dhe më pastaj të luftohet i njëjti në jetën reale.⁷⁰

Nuk duhet haruar se masat represive që shqiptohen lidhur me veprat penale duhet të përshtaten me personalitetin dhe karakterin e personit që shkon në vuajtje të dënimit që të mund të konsiderohet që do të arrihet rezultati kryesor që është risocializimi i personit dhe kthimi i tij në shoqëri, pra me shqiptimin e këtyre masave shteti me monopolin e forcës nuk i shqipton këto masa me qëllim hakmarrjen po qëllimi është që të arrihet risocializimi dhe edukimi adekuat i personit dhe që të mund të kthehet në shoqëri përsëri.

Është e vërtet e pa mohueshme që në rastin më të keq në qoft se masat represive të ushtruara nuk janë conform personalitetit të personit që i shqiptohen dhe njëkohësisht e dëmtojnë shumë se sa e ndihmojnë të njëjtin kjo tregon për dështimin e këtyre masave që parashihen në luftimin e krimit në shoqëri dhe mbrojtjen e shoqëris prej tij.

Në vijën e para të frontit për luftimin e krimit janë organet shtetërore si policia, prokuroria, gjykata por edhe entet penitensiare në të cilat vuajn dënimin personat që kanë kryer krime. Këtu duhet cekur edhe rëndësia e zbatimit në mënyrë të përpikt të ligjit dhe akteve tjera nënligjore me qëllim luftimin e kriminalitetit në tërësi, askush nuk është mbi ligjin, ligji është mbi të gjithë.⁷¹

⁷⁰ Po aty, faq.127-130

⁷¹ Po aty, faq.257-265

3.1. Institucione kompetente në luftimin e vrasjeve të kualifikuara

Organet kompetente që kanë rolin kryesor në luftimin e kriminalitetit përfshir këtu edhe vrasjet e kualifikuara janë policia, prokuroria, gjykata dhe entet penitensiare. Është e pa mohueshme rëndësia e organeve të lartë përmendura për ndërmarjen e veprimeve adekuate në luftimin e krimit.

3.2. Policia

Policia ka rolin shumë të rëndësishëm në luftimin e kriminalitetit kjo për vet faktin se policia është ajo e cila në teren lufton krimin dhe meret drejtpërdrejt me të njëjtin. Policia e fillon ndjekjen e krimeve e para dhe pastaj vazhdohet zinxhir në organet tjera kompetente.

Në mbrojtjen e jetës si vler kryesore policia është ajo e cila fillimisht vendos rendin dhe qetësin në shoqëri, policia është ajo e cila i ndjek kriminelët hap pas hapi dhe puna e policis nuk duhet që të nënvlersohet pasi që ajo është e rëndësis së veçant në mbrojtjen e shoqëris nga krimi. Policia me veprimet e saj në kohë dhe momentin e duhur pamundëson në kryerjen e vrasjeve dhe veprave tjera penale, zbulimin e autorëve të veprave penale, kapjen e personave në kërkim, kryerjen e hetimeve dhe sigurimin e provave për vazhdimin e çështjes në prokurori.

Rëndësia e luftimit të kriminalitetit shihet në atë që sa e suksesshme është policia në atë shkall shihen siguria në shoqëri dhe në parandalimin dhe mbrojtjen e shoqëris nga krimi, dështimi i policis dhe korruptimi i saj nënkupton se një mekanizëm shumë me vler ka dështuar në mbrojtjen e shoqëris në tërësi.

Policia në shtetin tonë për të kryer detyra e saj dhe për të parandaluar kriminalitetin mund të ndërmar veprime si më posht: të kryejë kontroll të automjeteve, të udhëtarëve dhe të valixheve, të kërkojë informacione të nevojshme nga qytetarët, të kufizoj lëvizjen në një vend të cakutuar për kohë të caktuar, të identifikoj personat dhe sendet, ndërmarrrja e masave të nevojshme për të gjetur personin ose sendet që kërkohen, kontrollimi i objekteve publike në prezenc të personit përgjegjës dhe shqyrtimi i dokumenteve të nevojshme, konfiskimi i sendeve që mund të konfiskohen në bazë të kodit penal të RMV-së dhe veprme të tjera të nevojshme.⁷²

⁷² Sahiti.E & Zejnli.I, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Tetovë, 2007, faq.98-99

3.3. Prokuroria

Pas policis në frontin e luftimit të kriminalitetit gjendet edhe prokuroria e cila punën e policis e vazhdon me veprimet e nevojshme procedurale për të ndëshkuar kryerësit e përgjegjshëm të veprave penale.

Prokuroria është organ shtetëror që ka për qëllim ndjekjen e kryerësve të veprave penale dhe të veprave tjera të ndëshkueshme kryen edhe detyra tjera të parashikuara me ligj. Prokuroria në ndërmarjen e veprimeve për ndjekjen dhe zbulimin e kriminalitetit ka rolin parësor për realizimin e hetimeve të shpejta, të sakta, objektive në zbulimin e kryerësve, sigurimin e provave dhe nxjerrjen e kriminelëve para drejtësis për të vuajtur dënimin e tyre të merituar. Prokurori si organ shtetëror bashkpunon edhe me organe tjera shtetërore, si policia, gjykata por edhe me qytetarët pa të cilët vështir se do të arriheshin rezultate të duhura në këtë drejtim. Bashkpunimi i ngusht mes prokuroris dhe qytetarëve do të arrihen rezultate të mira në luftën e përbashkët kundër krimit që është prezent në shoqëri. Jo çdo gjë mund të arrij vetëm prokuroria dhe për këtë shkak është më se e nevojshme bashkpunimi i ngusht me çdo kënd i cili është i gatshëm që të ndihmoj në zbardhjen e rasteve penale dhe ndëshkimin e kryerësve të tyre.

Përveç funksionit kryesor të ndjekjes të veprave penale prokuroria ka për detyrë edhe ndjekjen dhe observimin e dukurive të ndryshme kriminale që janë të rrezikshme për shoqërin, po ashtu prokuroria jep propozim deri tek Kuvendi i RMV-së masa për parandalimin e dukurive të rrezikshme dhe forcimin e sundimit të ligjit.⁷³

Efikasiteti i prokuroris nënkupton shoqëri me të sigurt dhe jetë më komode për qytetarët e saj. Vlera e pa kontestueshme e prokuroris në luftimin e kriminalitetit është e lart por nuk është e mundëshme vetëm roli i prokuroris por edhe gjykata dhe entet penitesiare kanë rolin e tyre të pa mohueshme për luftimin e kriminalitetit pasi që në rast se prokuroria e realizon punë e saj por institucionet tjera si gjykata apo edhe entet penitesiare nuk e realizojn në mënyrë adekuate atëher roli i njërit institucion bije posht si i pa vler dhe humbet rëndësia dhe qëllimi i luftimit të kriminalitetit në shoqëri. Duke pasur parasysh edhe shkallën e lart të korrupsionit në shtetin tonë kjo e pa mundëson efikasitetit dhe suksesin e dëshiruar të institucioneve kompetente të luftimit të kriminalitetit.

⁷³ Po aty, faq.96-98

3.4. Gjykata

Pas policis dhe prokuroris rol vendimtar ka edhe gjykata e cila sjell vendim gjyqëror qoft aktvenim apo aktgjykim për çështjet të cilat paraqiten para gjykatës për të vendosur. Vlera e madhe e gjykatës në luftimin e kriminalitetit përfshir këtu edhe në mbrojtjen e shoqëris e realizon me funksionin e saj kryesor në gjykimin e kryerësve të veprave penale. Rëndësia e gjykimit konsiston në atë që me vendime të drejta dhe të pa anëshme gjykata ndëshon kryerësit e veprave penale dhe njëkohësisht i dërgon mesazh personave të tjer që kanë në plan për të kryer krime që do të ndëshkohen për veprat e tyre. Pra gjykata me vendimet e saj ka rolin e preventivës gjenerale dhe special dhe kjo është shumë e rëndësishme për luftën drejtuar krimin në shoqëri.

E drejta e qytetarit, që ta gjykoj një gjykatës i pavarur dhe i paanshëm është postulati themelor i pushtetit gjyqësor. Pavarësia dhe paanshmëria janë vlera të pushtetit gjyqësor të cilat garantohen me Kushtetutën e RM, me ligjet e RM dhe me dokumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga RM.⁷⁴

Gjykatat në shtetin tonë gjykojnë në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe në bazë të marrveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe sigurojnë zbatimin e të drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Objektivat kryesore të gjykatave janë: zbatimi i ligjit në mënyrë të pa anshme dhe objektive pa marrë parasysh pozitën e personave të cilët paraqiten përpara gjykatës, përparimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, sigurin juridike dhe krijimin e kushteve që çdo njeri të jetoj në siguri në aspektin e zbatimit të ligjit.

Pa anshmëria dhe pamvarsia e gjykatave është vler e cila duhet respektuar fillimisht nga pushtetet ekzekutiv dhe ligjvënës që të mos ndikjon me veprimet e tyre dhe presionet e ndryshme mbi pushtetin gjyqësor dhe mbi vendimet e tyre gjyqësore pasi që humbet rëndësia dhe vlera e gjyqësis. Në shtetin tonë fatkeqësisht çështja e gjyqësis është polemizuar shumë shpesh nga ana e pushtetit ekzekutiv me intervenimet e tyre dhe vihet qart në diskutim paanshmëria e sistemit gjyqësor aktual, është shumë e nevojshme që ky system aktual të reformohet me njerëz të rinjë dhe të aftë për punën që do ta kryejn punënë e gjykatësi,prokurorët dhe çdo i punësuar tjetër në gjykatë , përzgjedhja e gjyqëtarëve të mos

⁷⁴ Ligji për gjykatat “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/06 35/08, U. nr. 256/07, U. nr. 74/08,150/10, U. Nr . 12/.

bëhet me lidhje partiake por në bazë të aftësive dhe meritokracisë që të kemi sistem gjyqësor të pavarur dhe shtet të së drejtës.

Po ashtu në shtetin tonë është përpiluar strategjia për reformën e sektorit gjyqësor për periudhën nga vitit 2017-2022, arsyeja kryesore për përgaditjen e strategjisë është rekomandimi nga ana e KE për shkak të gjendjes në sistemin gjyqësor deri në vitin 2015 si dhe skandali lidhur me përgjimet dhe gjendja shumë e keq në gjyqësor dhe njohurit që morën qytetarët në përgjime ishin tronditëse dhe për atë shkak qeveria mori hap që të realizoj reformimin e sistemit gjyqësor.

Strategjia në fajlë ka këto qëllime kryesore:

-Që të paraqes unitetin dhe identifikimin dhe tejkalimin e problemeve që janë prezente në gjyqësor;

-Vendosja e parimit të sundimit të ligjit si parimi më i lartë politik dhe ligjor në rregullimin e marrëdhënieve midis tre mbajtësve të pushtetit, duke respektuar pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e pushtetit gjyqësor;

-Largimi nga rendi ligjor i ligjeve që rrezikojnë pavarësinë, paanshmërinë dhe gjyqtarëve dhe autonominë e prokurorisë publike;

-De-profesionalizimi dhe përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për përgjegjësinë e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë;

-Reforma e gjyqësorit administrativ me qëllim të realizimit efikas të funksionit të tij dhe kontrollit mbi aktet e pushtetit elcëkativ dhe të administratës shtetërore;

- Forcimi i funksionimit të PSP si një institucion i pavarur brenda PP-së në trajtimin e alctëve të kompetencës së saj dhe ndjekjes penale të veprave penale të profilit të lartë "krim i bardhë";

-Rivlerësimi i sistemit gjyqësor dhe sistemit të prokurorisë publike nga aspekti i rrjetit dhe kompetencave të institucioneve, ekipimit të tyre kadrovik dhe material

-Forcimi i sistemit të edukimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve të gjykatësve, prokurorëve publikë dhe avokatëve

-Forcimi i mekanizmave të transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë përmes sistemit të vetë-rregullimit të shoqatave të tyre profesionale.

Këto dhe shumë qëllime të tjera janë të përfshira në strategjin për reformimin e gjyqësorit duke u bazuar në rekomandimet e KE, por sa rezultate do të arrin në realitet kjo është një çështje e cila duhet që ta lëm në dorë kohës dhe të shohim rezultatet e parapar.⁷⁵

3.5. Entet penitensiare

Pas gjykatë rol po ashtu me rëndësi kanë edhe entet penitensiare në realizimin e qëllimit kryesor për mbrojtjen e shoqëris nga kriminaliteti por edhe riedukimin e personave që qëndrojnë në këto ente me qëllim përgaditjen që ata të mund të kthehen në shoqëri përsëri si qytetar të rregullt të shoqëris. Organizimi efikas i këtyre enteve dhe mënyra profesionale e personave që janë përgjegjës për kontrollimin, ruajtjen, arsimin e personave në ente do të thotë që është arritur me sukses që ata persona janë përgaditur që përsëri të kthehen në shoqëri dhe të mos i përsëritin krimet e më parshme.

Në shtetin tonë entet janë të ndara në institucione ndëshkuese- korrektuese dhe institucione edukuese-korrektuese. Në institucionet ndëshkimore-korrektuese bëjnë pjesë shtëpit ndëshkimore-korrektues dhe burgjet. Kompetencë për ekzekutimin e sanksioneve është drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve. Nëse shtetin tonë burgje kemi në disa qytete edhe atë në Manastir, Gjevgjeli, Kumanovë me repar të hapur në Kriva Pallankë, Ohër, Prilep, Strumicë, Shkup, Tetovë ndërsa shtëpi ndëshkimore korrektuese kemi në Idrizovë me repar të hapur në Veles, Shtip, Strugë. Po ashtu kemi edhe ente edukuese-korrektuese një në Tetovë dhe një në Shkup.

E rëndësishme së veçantë është që në këto institucione fillimisht personi i cili shkon në vuajtje të sanksionit të parapar me ligj duhet që të observohet lidhur me aftësit e tij, njohurit, gjendjen emocionale, fizike, shëndetësore dhe pas asaj të trajtohet në bazë të njohurive të fituara nga observimi pasi që jo çdo personi mund që të vendosen masa të njejta dhe rezultatet të jenë të njejta pasi që njeriu dallon nga njëri tjetri dhe për këtë shkak është shumë i rëndësishëm observimi që u bëhet në momentin që arrin në entin për vuajtje të dënimit.

Po ashtu në institucionet ndëshkimore-korrektuese janë të ndarë në sektore të ndryshme duke filluar nga sektori për risocializim pastaj sektori për siguri, ekonomik-instruktues, shëndetësor, administrativ-ekzekutiv dhe financiar. Çdo njëri nga sektorët e më sipërm kanë rëndësinë e veçantë për realizimin në mënyrë profesionale qëllimin për risocializim të kryerësve të krimeve

⁷⁵ <https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/STRATEGJIA%20%202017.pdf>

por i rëndësis së veçant është sektori për risocializim i cili ka për qëllim edukimin, arsimimin dhe aftësimin e personave të dënuar me qëllim përgaditjen e tyre për jetë jashtë burgut. Realizimi me sukses i këti procesi nënkupton që është arritur qëllimi primar në mbrojtene e shoqëris nga kriminaliteti dhe luftimin me sukses të krimit në shoqëri përfshir këtu edhe vrasjet e kualifikuara që konsistojn në privimin nga jeta e njeriut si vler më të rëndësishme njerëzore.⁷⁶

Sipas raportit të Këshillit të Evropës për statistikën vjetore të dënimeve, edhe katër vende janë në listën e stërmbushjes së burgjeve me më shumë të burgosur se sa vende janë planifikuar, edhe atë Greqia me 101, Austria me 100.7 Sllovenia me 100,5 dhe Danimarka me 100,5.

Sipas raportit, në Maqedoni numër më i madh i të burgosurve gjenden në burgun e Idrizovës, me gjithsej 1134 të burgosur, ndërsa në burgun hetues të Shutkës janë 108 veta të dënuar dhe 270 persona në paraburgim. Megjithatë në Maqedoni ka rënë numri i të burgosurve në krahasim me vitin e kaluar për 9.7%, ndërsa zvogëlimi më i madh i numrit të të burgosurve është në Rumani me 16%.⁷⁷

4. Ndhma, mbrojtja dhe kompenzimi i viktimave të vrasjeve të kualifikuara

Pasoajt nga veprimet kriminale sidomos nga vrasjet e kualifikuara përveç viktimës që e përjeton drejtpërdrejt pasojat i përjetojn edhe familja e viktimës dhe për atë shkak është më se e nevojshme që të kompenzohen viktimat e krimeve përfshirë këtu edhe tek vrasjet e kualifikuara. Sot në botën bashkohore dita ditës po i kushtohet një rëndësi më e madhe viktimave të të gjithë llojeve të kriminalitetit, pasi që në të kaluarën shkenctarët dhe studiuesit janë marrë vetëm me kryerësin dhe e kanë lënë anash viktimën e cila realisht i përjeton pasojat më të mëdhaja nga krimi. Fillimisht do të cekimi se çka nënkupton me viktimizim primar dhe çka nënkupton me viktimizim sekondar. Viktimizimi primar paraqet pësimin direkt që e përjeton viktimia nga vepra penale, ku pësim mund të jetë material, fizik, shpirtëror apo psikik, ndërsa viktimizim sekonda nënkuptojm kur viktimia mundohet që rastin ta paraqes në institucionet kompetente për ndëshkimin e kryerësit dhe ajo nga organet kompetente fyhet dhe përçmohet edhe më shumë nga njerëzit që ata realisht duhet ta ndihmojn në rastin e saj. Si shembull

⁷⁶ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare R.M-së, nr.57, 26.04.2010

⁷⁷ https://books.google.mk/books?id=zJ1hFnP_zlUC&pg=PA24&lpg=PA24&dq=raporti+i+keshillit+te+evropes+per+burgjet&source=bl&ots=peQVn9LoUU&sig=ACfU3U3J8_vDtNGYXmxDMOtUĒDFTzLg3Yë&hl=en&sa=X&ved=2ahUKĒëjA8af8n8DpAhĒILsAKHRFĒD8AQ6AEĒA3oECAoQAQ#v=onepage&q=raporti%20i%20keshillit%20te%20evropes%20oper%20burgjet&f=false

konkret mund të cekim policin ku qytetarët i drejtohen për hallet e tyre dhe shpesh ata viktimizohen përsëri dhe kjo mund të jetë edhe shkak që viktimat nuk i paraqesin rastet në organet kompetente por ata mundohen që ti zgjidhin vet problemet. Përveç jo profesionalizmit në kryerjen e detyrave të punsuarve, viktimat nuk i paraqesin në polici për shkak se nuk ju besojn organeve shtetërore por edhe sepse ata nuk kanë njohuri për të drejtat e tyre, nuk njoftohen në kohë me të drejtat e tyre dhe nuk janë të informuar sa duhet për ligjin dhe mungesa e ndihmës që mungon në organet shtetërore e shton edhe më tej numrin erët të kriminalitetit në statistikatat shtetërore për krimin.

Tek vrasjet e kualifikuara për shkak të rëndësis së saj shumë autor të ndryshëm i kanë studiuar edhe raportet mes viktimave dhe kryerësve duke arritur në një përfundim që tek këto lloje të veprave penale është karakteristike se viktimat me kryerësin ka patur raporte të caktuara si lidhje familjare, lidhje shoqërore, raporte pune apo biznesore të cilat kanë shtyrë që kryerësi të kryej vrasjen. Në kryerjen e vrasjeve të kualifikuara shpesh ndikojn edhe xhelozia apo dashuria e madhe për një person e cila detyron në kryerjen e veprimeve të pa kontrolluara dhe të pamatura.⁷⁸

Tek viktimat e vrasjeve të kualifikuara duhet treguar kujdes i veçant për arsye se të afërmit kanë humbur familjar të tyre, ata meritojnë kompensim dhe dëmshpërblimin e duhur në këtë drejtim, gjykatat duhet të tregohen sa më efikase dhe të shpejta dhe objektive në ndëshkimin e kryerësve të këtyre krimeve pasi që pasojat janë të rënda për shoqërinë. Nëse ne hudhim një sy në ligjet penale në shtetit tonë mund të vërejm se shumica e tyre janë të drejtuara kah kryerësi i veprës penale dhe një pakic e tyre nga viktimat dhe për këtë shkak është e nevojshme që të drejtat që i gëzon kryerësi në procedur ti gëzoj edhe viktimat, të drejtat e viktimës të mos kufizohen vetëm në kërkesën për kompensimin e dëmit me një fjal të arrihet një balance mes viktimës dhe kryerësit të krimit. Sa realisht kjo realizohet në shtetin tonë është çështje e cila nuk është fort e kënaqëshme dhe nevojitet edhe më tej të punohet në këtë drejtim për përmisimin e të drejtave të viktimave.

⁷⁸ Halili.R, Viktimologjia, Prishtinë, 2011, faq.64-69

Kapitulli IV

Studimi empirik dhe paraqitja e të dhënave statistikore

1. Pasqyrë e përgjithshme lidhur me të dhënat statistikore të siguruara nga enti statistikor lidhur me vrasjete e kualifikuar

Vepra penale vrasje e kualifikuar është veper e cila rrezikon në masë shumë të madhe shoqërinë dhe pasur pasqyrë edhe pasojat e rënda që pasojnë nga kjo veprë penale është shumë e rëndësishme të kemi informata lidhur me atë se sa vepra penale janë kryer në shtetin tonë, sanksionet e shqiptuara ndaj kryerësve dhe efekti i tyre në shoqëri.

Duke u bazuar në të dhënat e siguruara nga enti statistikor në vitin 2017 tek vepra penale kundër jetës dhe trupit kemi 4 raste ku janë shqiptuar dënime me burg mbi 20 vite, në vitin 2018 kemi vetëm një rast, tek vepra penale vrasje në vitin 2017 kemi 4 raste të dënuar me burg mbi 20 vite ndërsa në 2018 kemi vetëm një rast të dënuar me mbi 20 vite pra nga këto të dhëna shihet një zvoglim i numrit të veprave penale drejtuar jetës dhe trupit.

Nëse krahasojmë meshkujt dhe femrat si kryerës të veprave penale atëherë shohim qart se si kryerës më të shpesht paraqiten meshkujt ndërsa femrat paraqiten më pak pra si viktimë më të shpeshta të vrasjeve të kualifikuara paraqiten prap meshkujt ndërsa femrat më së shpeshti paraqiten viktimë tek dhuna në familje, tregëtia me femra dhe shumë forma tjera të krimeve.


Nëse shohim aspektin e arsimimit nga të dhënat e siguruar nga enti shtetror për statistika për veprat penale kundër jetës dhe trupit qart konstatohet se si kryerës të krimeve paraqiten të gjithë personat pa dallim se kanë kryer apo jo arsimim dhe edukim të lart. Nga këto të dhëna në vitin 2017 si kryerës të veprës penale kundër jetës dhe trupit me arsimim të mesëm dhe të lart paraqiten 332 dhe 43 kryerës që tregojnë qart se edhe personat me arsimim dhe shkollim të lart paraqiten kryerës të krimeve ndërsa në vitin 2018 e njëjta kategori e personave përsëri paraqiten me numër të lart edhe atë 291 me arsimim të mesëm dhe 46 me arsimim të lart. Krahasuar me personat me arsimim të ulët dhe ato pa arsimim qart kuptohet se personat me shkollim dhe arsimim janë ata që më së shpeshti janë kryerës të krimeve kundër jetës dhe trupit dhe e hüdhen posht tezën se personat me shkollim të ulët dhe pa shkollim janë ata që kryejnë krime më së shpeshti.⁷⁹

⁷⁹ <http://makstat.stat.gov.mk/PXËeb/sq/dd4f6fc4-42be-4fd6-a4cc-b2ac81b05a7>

1.1. Grafikon lidhur me të dhënat statistikore

		2017	2018
Krimet kundër jetës dhe trupit	Burg mbi 20v	4	1
	Burg 10-15v	1	2
	Burg 5-10vite	6	4
Vrasjet	Burg 3-5v	8	2
	Burg mbi 20v	4	1
	Burg 10-15v	1	2
	Burg 5-10v	6	4
Demtime trupore	Burg 3-5v	4	1
	Burg mbi 20v	/	/
	Burg 10-15v	/	/
	Burg 5-10v	/	/
Demtime të rënda trupore	Burg 3-5v	1	/
	Burg mbi 20v	/	/
	Burg 10-15v	/	/
	Burg 5-10v	/	/
	Burg 3-5v	3	1

Grafikoni nr. 1 tregon sanksionet që janë shqiptuar ndaj kryerësve të veprave penale.



Grafikoni nr.2 tregon numrin e personave të paraqitur, të gjykuar dhe të dënuar në bazë të gjinis dhe viteve⁸⁰

	2017				2018			
	Pa shkollim	Me shkollim të pa përfunduar	Me shkollim të mesëm	Me shkollim të lart	Pa shkollim	Me shkollim të papërfunduar	Me shkollim të mesëm	Me shkollim të lart
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	16	22	131	332	21	37	156	291

Grafikoni nr.3 tregon për veprat penale kundër jetës dhe trupit ku klasifikimi është bërë në bazë të viteve dhe shkollimit dhe arsimimit të kryerësve⁸¹

⁸⁰ http://makstat.stat.gov.mk/PXËeb/pxëeb/mk/MakStat/MakStat_Sudstvo/125_SK2_ml_T-19.px/table/tableVieëLayout2/?rxid=af367976-d387-4c7f-accb-d8cbffe5ff53

⁸¹ http://makstat.stat.gov.mk/PXËeb/pxëeb/mk/MakStat/MakStat_Sudstvo/450_SK2_ml_T-20_px.px/table/tableVieëLayout2/?rxid=af367976-d387-4c7f-accb-d8cbffe5ff53

2. Analizë e aktgjytimeve të Gjykatës Themelore në Tetovë

I gjithë hulumtimi do të ishte i zbeht në qoft se nuk do siguronim edhe të dhëna nga gjykata ku atje zhvillohet realisht beteja për sanksionimin dhe ndëshkimin e kryerësve të veprave penale. Funkcionaliteti dhe paanshmëria e gjykatave nënkupton edhe shtet të së drejtës të cilin e dëshirojm të gjithë dhe po mundohemi që ta arrim me çdo kusht të mundshëm.

Në bazët të dhënave që kemi arritur që ti sigurojm nga gjykata janë si vijojn:

Gjykatës	Numri i lëndës	Vepra	Vendimi
B.J	K-443/14	Vrasje	Dënim me burg
V.K	K-117/14	Vrasje	Dënim me burg
V.K	K-211/14	Vrasje	Dënim me burg
V.K	K-777/14	Vrasje	Dënim me burg
V.K	K-787/14	Vrasje	Dënim me burg
Z.E	K-216/14	Vrasje	Dënim me burg
Z.E	K-543/14	Vrasje	Dënim me burg
Z.E	K-847/14	Vrasje	Dënim me burg
J.V	K-156/14	Vrasje	I liruar nga dënimi
J.V	K-42/14	Vrasje	I liruar nga dënimi
J.V	K-523/14	Vrasje	Dënim me burg
J.V	K-523/14	Vrasje	Dënim me burg
J.V	K-85/14	Vrasje	I liruar nga dënimi
J.V	K-872/14	Vrasje	Dënim me burg
N.I	K-656/14	Vrasje	Dënim me burg

Të dhëna të siguruara nga gjykata lidhur me vrasjet dhe sanksionet e shqiptuara në vitin 2014

Gjykatës	Numri i lëndës	Vepra	Vendimi
B.J	K-185/15	Vrasje	Dënim me burg
B.J	K-674/15	Vrasje	Dënim me kusht
B.J	K-712/15	Vrasje	Dënim me burg
B.J	K-735/15	Vrasje	V.p është vërtetuar se e ka kryer i akuz.
B.J	K-791/15	Vrasje	Dënim me burg
B.Z	K-580/15	Vrasje	V.p është vërtetuar se e ka kryer i akuz.
V.K	K-102/15	Vrasje	Dënim me burg
V.K	K-597/15	Vrasje	Dënim me burg

V.K	K-656/15	Vrasje	Dënim me burg
V.K	K-713/15	Vrasje	Dënim me burg

Të dhëna të siguruara nga gjykata lidhur me vrasjet dhe sanksionet e shqiptuara në vitin 2015

Më posht do të paraqesim dy raste nga Gjykata Themelore Tetovë e cila ka shqiptuar dënime ndaj kryerësve të veprave penale rastet janë me numër K-318/16 dhe K-321/17- të cilat do ti elaborojm në mënyrë të detajuar më posht.

K-318/16

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONIS

GJYKATA THEMELORE NE TETOVË

Si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtaren Sadulla Izairi si Kryetar i Këshillit, me gjyqtar Hasan Asani si anëtar të Këshillit, me gjyqtarët porot Nebi Abdii, Sabije Misimit dhe Todeleta Kovaca Lechavska, me procesverbal Nr. 2525/04, datë 28.07.2004 i Prokurorisë Publike-Tetovë me të cilën akuzohet nga Tetova për veprën penale të Vrasjes nga neni 123 paragrafi 2, pika 3 e Kodit Penal, pas seancës kryesore, publike dhe gojore të mbajtur më 10.07.2017, dhe në prani të Prokurorit Publik Besir Aliu, të pandehurit XY dhe avokati Ibrahim Bajrami nga Tetova dhe avokati i të dëmtuarit Elvir Iseni nga Tetova, i miratuar dhe shpallur publikisht më 13.07.2017, në vijim shpall

AKTGJYKIM

Aktgjykimi K.NR.313 / 04 datë 12.11.2004, i plotfuqishëm me 01.09.2005, në tërësi shfuqizohet në përputhje me nenin 423 paragrafi 3 të LPP-së.

I akuzuari nga babai .. dhe nëna, lindur më ... vit. në Tetovë, ku jeton në rrugë "... " ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë, i papunë, i martuar, baba i dy fëmijëve, dhe po vuan masën e paraburgimit, për të cilën është duke u zhvilluar procedurë penale tjetë

ËSHTË FAJTOR

Më 12 qershor 2004, rreth orës 01:00, para lokalit "Guri i Zi" i vendosur në Rr.pa numër në Tetovë, ai vrau me dashje të ndjerin tani ... nga Tetova, dhe me qëllim rrezikoi jetën e ..., të dy nga Tetova, duke përdorur pistoletën e tij - një markë e panjohur e kalibrit 9 mm, të cilën ai e zotëronte pa leje, ai gjuajti disa plumba në drejtim të të ndjerit tani .., dhe me njërin e goditi në

zonën e shpatullës së majtë, duke i shkaktuar një lëndim vdekjeprurës ndaj tij, dhe më pas ai u kthye përsëri dhe gjuajti disa plumba në të. dhe të cilat gjendeshin afër terrasës së lokalit, për të cilën për shkak të gjakderdhjes së brendshme të shkaktuar nga këputja e arteries polmunare i ndjeri vdiq gjatë rrugës për në spitalin klinin në Tetovë.

Me këtë veprim, i pandehuri kreu veprën penale të Vrasjes nga neni 123, paragrafi 2, pika 3 e Kodit Penal. Sipas këtij neni, anëtarët: 32,33,35 dhe 39, nga KP,

E gjykon

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 10- (Dhjetë) - VITESH.

Të paguaj

Në emër të një shumë paushale penale 5,000, denarë, dhe në emër të kompensimit të kostove të tjera në procedurën penale në shumën prej 20,000 denarë në llogari të buxhetit të shtetit të gjitha brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e aktgjykimit.

Të dëmtuarit dhe si dhe përfaqësuesi ligjor i të ndjerit tani .., për pretendimin e tyre të mundshëm mund të drejtohen në proces gjyqësor civil.

ARSYETIM

Me aktakuz K.O nr.225/04 prej 28.07.2004 të prokuroris publike Tetovë i akuzuar është XY për kryerjen e veprës penale Vrasje nga neni.123 paragrafi.2 pika.3 të K.P. të R.M

Pas aktakuzës, gjykata caktoi dhe mbajti seancë kryesore gjyqësor më 10.07.2017 në prani të përfaqësuesit të prokurorisë, prokurorit publik, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, avokatit të dëmtuarit Elvir. Iseni, ashtu si me vendimin e Gjykatës Themelore Tetovë K- 3/16 nga 17.02.2016, lejohet të përsëritet procedura penale kundër të dënuarit xx nga Tetova me aktgjykimin K.br.313 / 04 nga 12.11.2004 dhe i vlefshëm me 01.09 0,2005. Prokurori i Përgjithshëm Besir Aliu tha në fjalën e tij përmbyllëse se ai qëndron pas aktakuzës dhe fakteve të paraqitura në mënyrë të shkruara dhe se i pandehuri ishte fajtor dhe kërkon nga gjykata që ta ndëshkoj në përputhje me ligjin.

Në fjalën e tij përmbyllëse, avokati i të dëmtuarit, Elvis Iseni, deklaroi se edhe ai mendon njejt si prokurori publik dhe kërkoj që të dënohet i pandehuri në përputhje me ligjin dhe lidhur me kërkesën për dëmet materiale të jenë si kërkes në prcesin gjyqësor.

Në fjalën e tij përmbyllëse, avokati i të akuzuarit Ibrahim Bajrami nga Tetova deklaroi se provat faktike në procedurat e deri tanishme vërtetuan pjesërisht situatën faktike, është e padiskutueshme që klienti i tij ka kryer krimin, nga deklarata e dhënë gojarisht para gjykatës, nga i cilia vijon se ai e ka kryer krimin pa qëllim, në pakujdesi ekstreme me ndjeshmëri të zvogëluar në kohën e kryerjes së veprë penale dhe kërkon nga gjykata që të ketë parasysh të dhënat dhe faktet e paraqitura në mënyrë të shkruar, po ashtu të ketë parasysh deklaratën e dhënë në seancën kryesore të pandehurit i cili në sharzherin e armës ka pasur 15 plumba dhe ka gjuajtur vetëm tre prej tyre, në qoftë se do të kishtë qëllim vrasjen dhe shkaktimin e dëmeve edhe personave tjerë do ti përdorte edhe plumbat tjerë, ngjarja e pakëndëshme ka ndodhur pa paramendim dhe kërkoj nga gjykata që të shihen edhe rrethanat lehtësuese për të pandehurin duke pasur parasysh se ai ka krijuar familje dhe është prind i dy fëmijëve dhe gjendjen e tij pronsore duke pasur parasysh këto rrethana lehtësuese kërkojm nga gjykata që ti shqiptohet dënim sa më i ultë në kornizat ligjore.

Në fjalët përfundimtare i pandehuri theksoj se mbështete në atë që tha avokati i tij dhe dëshiroj që edhe një here tjetër ti kërkoj falje familjes së të ndjerit dhe se nuk është person i keq dhe se në të ardhmen do të ketë më shumë kujdes ndaj veprimevet të tija

Pas kësaj gjykata caktoi dhe mbajti seancë gjyqësor më 10.07.2017, dhe ka nxjerrur provat e mëposhtme: raport për inspektimin në vend ID.nr.101 / 04 nga 12.06.2004, tek gjykatësi hetues të kësaj gjykate, kodin nr 671/04 të Ministrisë së Brendshme Krime - Teknikë Tetovë, protokoll i seksionit PS nr.33 - Shërbimi i Mjekësisë Ligjore, ekspertiza nr 500/2004 e Ministrisë së Brendshme – Krimi teknika, protokoll i seksionit PS nr 06-53 / 2004, datë 12.06.2004, përgatitur nga Spitali klinik Tetovë për dëmtimet që ka pësuar i ndjeri, në emër të të pandehurit një vërtetim që personi nuk është i regjistruar si mbajtës i së drejtës në kadastrën e pasurive të patundshme, konfirmim që i pandehuri nuk është përfitues i ndihmës sociale, certifikatë e të ardhurave, certifikatë lindjeje e lëshuar nga 10.05.2017. për Deliza Bafqari, certifikatën e lindjes lëshuar në 10.05.2017, në emër të Diar Bafqari, certifikata e martesës me nr.11446/1979, letra e pushimit nga puna në emër të babait të të pandehurit, datë 19.04.2001, në marrëveshje me palët, gjykata lexoi dëshminë e dëshmitarit xx dhënë nga 08.07.2004, dhe me nr 132/04 dhe procesverbalit nga seanca kryesore nga 28.09.2004, dëshmi nga dëshmitari xx por dhënë në procesverbalet, të gjitha provat në përputhje me nenin 14 dhe nenin 365 të LPP, konstaton gjendjen e mëposhtme faktike:

I pandehuri i lindur në 1979 në Tetovë, i martuar, baba i dy fëmijëve, dhe po vuan masën e paraburgimit për të cilën po zhvillohet një procedurë tjetër penale, i njëjti

Më 12 qershor 2004, rreth orës 01:00, para lokalit "Guri i Zi" i vendosur në 113 bb. në Tetovë, ai vrau me dashje tani të ndjerin XYnga Tetova, dhe me qëllim rrezikoi jetën e xx dhe xx, të dy nga Tetova, duke përdorur armën e tij - një markë e panjohur e kalibrit 9 mm, i cili e zotëronte atë pa leje qëllon disa plumba në drejtim të xy tani të ndjerë ku me një plumb i shkaktoj plag vdekje prurëse në kraharonin e majt, ku pastaj gjuajti disa plumba në drejtim të xx,xx të cilët ndodheshin në tarasën e kafenes, ku për shkak të këputjes së arteries ndërojn jetë XY gjatë rrugës për në spitalin Klinik të Tetovës.

Kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes gjykata e vërtetoi nga raporti i vendit të ngjarjes të realizuar nga gjyqtari hetues në këtë gjykatë ku këto të prova i vërtetojn edhe dëshmitarët xx,xx. Nga këto prova dhe prova të tjera të cilat lidhen me njëra tjetrën vërtetojn se vepra është kryer 12.06.2004 rreth orës 01.00 para lokalit "Guri i Zi" që ndodhet në rrugën "113" Tetovë ku në momentet kritike kanë qenë përveç të ndjerit edhe xx,xx prezent

Rrethana që vdekja e të ndjerit tashmë XY është e dhunshme dhe që ajo ndodhi për shkak të gjakderdhjes së brendshme të shkaktuar nga këputja e arteries pulmonare nga një gëzhoj arme zjarri e cila shkaktoi ndërprerjen e organeve vitale jetësore, u konstatua nga ekspertiza e specialistit të autopsisë M.Sc. Dr. Agim Ramadani, specialist i mjekësisë ligjore.

Dëshmitarët xx, xx dhe xx dëshmuar dhe gjykata u dha atyre besim të plotë sepse ata të tre ishin dëshmitarë okularë dhe nuk kishin asnjë interes për të justifikuar apo për të dëmtuar të akuzuarit ku u vërtetua se privimi nga jeta i të ndjerit dhe rrezikim i jetës së dy personave është realizuar nga pandehuri xx, ku ai me armën 9mm të cilën e ka poseduar pa leje ka shtënë disa herë në drejtim të ndjerit ku me njërin nga plumbat e ka goditur në pjesën e majt të kraharonit dhe i ka shkaktuar lëndime vdekjeprurëse ku fillimisht është larguar dhe pastaj është kthyer dhe ka gjuajtur në drejtim të xx që ka qenë afër të ndjerit dhe ,xx i cili ka qenë brenda kafenes dhe ka rrezikuar edhe jetët e tyre

Se është gjuajtur me armën 9mm është vërtetuar nga raporti i MPB-së Shkup nga krimi teknika të cilët kanë kqyrur vendin e ngjarjes dhe përputhet me armën ku janë gjetur dy projektile njëri nga trupi i të ndjerit ndërsa tjetri i gjetur në vendin e ngjarjes

Gjendja faktike vërtetohet edhe nga thëniet e të pandehurit i cili në seancën kryesore nuk e mohon kryerjen e veprës penale madje në disa raste e pranon pjesërisht kryerjen e saj

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike gjykata konstaton se i akuzuari xx, e ka konsumuar veprën penale vrasje nga neni 123,par.2,p.3 të K.P ku ka privuar person nga jeta dhe ka rrezikuar persona të tjerë dhe e konsideron fajtor për vepën penale për të cilën ngarkohet.

Gjykata duke llogaritur dënimin në kufijt e lejuar me ligj për atë vepër, duke patur parasysh edhe përgjegjësin penale të akzuarit gjykata mori në konsideratë faktin se në kryerjen e krimit nuk kishte asnjë kontribut nga ana e viktimës dhe se krimi është kryer me një armë që i akuzuari posedonte pa leje , dhe si rrethana lehtësues fakti që që i pandehuri është një djalë i ri, i martuar dhe babai i dy fëmijëve, duke u penduar për kryerjen e krimit, i kërkoi falje familjes së të ndjerit, kanë kaluar shumë vite nga koha kur është kryer krimi, dhe sjellja e tij pas kryerjes së krimit.

Gjykat e hodhi posht kërkesën e palës mbrojtëse se i pandehuri ishte me shkallë të zvogluar të përgjegjësis dhe se në momentin e kryerjes së krimit nuk e ka kuptuar rëndësi e veprimeve të tij

Gjykata urdhëroi që i pandehuri të paguaj në emër të një shumë pausalle penale prej 5000, oo denarë, dhe në emër të kompensimit të kostove të tjera në procedurën penale në shumën 20,000, oo denarë, të gjitha brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e aktgjykimit.

Të dëmtuarit xx dhe xx, si dhe përfaqësuesi ligjor i të ndjerit tani xx, që ti drejtrohen procedurës civile.

Gjykuar në GJYKATA THEMELORE TETOVË më 13.07.2017. nën K.nr.318 /16v.

Porcesverbalist

Kryetar i trupit gjykues

Lepa Todeska

Sadulla Izairi

Udhëzim: E drejta për të apeluar kundër këtij aktgjykimi lejohet brenda 15 ditëve nga marrja e saj përmes kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit në Gostivar.

Prokurori publike-Tetovë, i akuzuar, avokat mbrojtës i pandehurit-Ibrahim Bajrami, avokat nga Tetova, avokat i të dëmtuarin Elvir Iseni, avokat nga Tetova

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKË SË MAQEDONISË

GJYKATA THEMELORE NE TETOVË

Gjykatësi NAZIF ILIJAZI, si Kryetar i Këshillit, gjykatësi Hirite Ceka dhe gjyqtarët porot: Sahit Emini, Vahide Haruni dhe Dushko Stankovski - si anëtarë të Këshillit me regjistruerin Zorica Jovanovska, në çështjen penale kundër të pandehurit ... nga fshati Palçishte për veprën penale të Vrasjes nga neni 123 paragrafi 1 i Kodit Penal. me nenin 19 të Kodit Penal, pas aktakuzës së Prokurorisë Publike Tetovë II KO nr.395/14 од 12.09.2014, , pas një seance kryesore, me gojë dhe publike, më 13.07.2017 në prani të Prokurorit Publik Besir Aliu, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij Adv. nga Tetova, solli dhe njoftoi publikisht si vijon:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

.., nga babai ..., nëna ..., i lindur më 18 tetor 1993 në Avezana, Itali, dhe jeton në fshatin e D. Palchishte me EMBG, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë, aktualisht duke vuajtur një masë paraburgimi në burgun e Tetovës, i pamartuar, i shkolluar me arsim të mesëm të përfunduar, pa pronë, kundër tij nuk zhvillohet procedur tjetër gjyqësore

ËSHTË FAJTOR

PËR ARSYE SE:

Më 20 Prill 2014, rreth orës 19:00 në interneti kafen "Benny" në pronësi të Arben Kadrija e vendosur në qendër të fshatit Rakovec, ai me dashje u përpoq të merrte jetën e xx të dëmtuar, të moshës rreth 19 vjeç nga fshati Palçishtë, në atë mënyrë që pa arsye e ka sulmuar me thikë me teh 7.5 cm. ku i ka shkaktuar lëndime të rënda trupor në zonën e qafës në formë rrethore me skaje të mprehta dhe thellësi 2 cm dhe i njeti ishte penguar nga kryerje e veprës nga pronari i sipër përmenduar ku ai kishte arritur që ta mera nga dora thikën dhe të pamundësoj përfundimin e veprës penale.

Akti me të cilin i pandehuri ka kryer veprën penale VRASJE sipas nenit 123 paragrafi 1 me nenin 19 të Kodit Penal dhe sipas atyre neneve si dhe me Art. 4,7,32,33,34, dhe 35 të KP, si dhe Art. 404, gjykata e gjykon fajtor dhe të njëjtin e ndëshkon me dënim me burg në kohë zgjatje prej

7(shtatë) vitesh ku në këtë periudh llogaritet edhe koha e kaluar në paraburim dhe në burg prej 08.11.16

Të paguaj

Në emër të shumës paushall në vler prej 3000.00 denar dhe në emër të shpenzimeve procedurale në buxhetin e gjykatës në vler prej 6500.00 (prej të cilave 3500.00 denar për kostatimet dhe mendimin e dhënë nga Dr. Agim Ramadani specialist i mjeksis ligjore si dhe 3000.00 denar për raportin dhe ekspertizën e realizuar nga ana Dr.Bllagoja Kocevski specialiste e neoripsikiatris që të dy raportet janë realizuar në spitalin Klinik në Tetovë, në afat kohor prej 15 ditësh nga maraj e aktgjykimit të formës së pres me mundësi të ekzekutimit me forcë.

Të akuzuarit i meret thika me gjatësi prej 7.5 cm si mjet me të cilin është kryer vepra penale

Ndërsa i dëmtuari për kërkesat e tij lidhur me dëmin e shkaktuar udhëzohet në procedur gjyqësore.

ARSYETIM

Prokurori publike Tetovë paraqiti aktakuzë në këtë gjykatë më 15.09.2014. nën II KO.br.395 / 14 nga 12.09.2014 kundër të pandehurit Xxnga fshati Palçishte, për veprën penale të Vrasjes nga neni 123 para. me nenin 19 të Kodit Penal.

Pas ngritje së aktakuzës, gjykata caktoi dhe mbajti seancën kryesore me 13.07.2017, në të cilën prokurori publik i propozoi gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor për veprën penale dhe të dënohet sipas ligjit, ndërsa masa e ndalimit të zgjatet deri në vlefshmëria e gjykimit për shkak të ekzistencës së bazës nga neni 165 paragrafi 1 pika 1 i LPP-së.

Gjatë seancës kryesore, i pandehuri pasi iu lexua më parë të drejtat që vijnë në procedurë, e pranoi fajin në tërësi, d.m.th pranoi se vepra penale e Vrasjes nga neni 123 paragrafi 1 i Kodit Penal. me nenin 19 të Kodit Penal, ai e ka kryer atë në atë mënyrë dhe kohës, vendit të përshkruar si në aktakuzë të Prokurorisë Publike-Tetovë nën II KO nr.395/14 të datës 12.09.2014.

Pasi që i pandehuri e pranoi plotësisht fajësinë dhe pasi gjykata u bind se i pandehuri kishte pranuar vullnetarisht fajësinë dhe se ai ishte në dijeni të pasojave juridike të pranimit të fajit, gjykata zhvilloi një seancë për dëmet e mundshme dhe kostot e procedurës gjatë seancës kryesore. Vetëm provat që lidhen me sanksionin penal u lexuan, kështu që si të tilla gjykata i

lexoi si vijojn: raporti i KE i dhënë në emër të të akuzuarit me nr.32.2.2-563 i datës 30.04.2014 nga MPB Tetovë si dhe dokumentacioni mjeksor i dhënë për të akuzuarin nga seksioni psiki-mental nga Dr.Roberto Lezo zyrtar në repartin për kontroll dhe kujdes psikiatrik në Oderzo të Italis me datë 22.04.2014, dokumentacioni i ekzaminimit nga njësia lokale sociale dhe shëndetësore nr.9, të gjitha të përkthyer në gjuhën maqedone, vërtetim për pranimin në spital dhe qëndrimin e të akuzuarit në Oderzo, raporti i specialistit dhe subspecialistit të kryer në spitalin klinik Tetovë e realizuar me datë 22.04.2014 me nr.540 si dhe raport nga Klinika Unversitare e Shkupit e datës 30.04.2014. Konfirmimi i pranimit nga krahina autonome e Bozel ose në rrethin e Tiroli Jugor zonën e spitalit Bozel nga data 06.05.2014 në emër të të akuzuarit për gjetjen dhe mendimin nr.24.6-33755 / 1 nga 05.07.2014 të Ministrisë së Punëve të Brendshme - Departamenti i Teknikës së Krimin, ekzaminimi dhe dëmtimi në Shkup, ekspertiza psikiatrike e Dr. Blagoja Kocevski, specialist neuropsikiatrik në Spitalin Klinik Tetovë nga 25.04.2014, si dhe dokumentacionin mjekësor të lëshuar në gjuhën italiane nga 30.11.2016.

Gjykata gjatë përcaktimit të lartësis së dënimit për të pandehurin duke i shqyrtuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese vendosi që rrethanat lehtësuese do të jenë më të rëndësishme në krahasim me ato rënduese, gjykata përcaktoi këto rrethan lehtësuese: që nuk është ngritur asnjë proces tjetër ndaj të pandehurit për ndonjë veprë tjetër, ai ka shkollim, shpreh keqardhje dhe pendim për krimin, sjelljet e tij të korekte gjatë procedurave dhe kontributin e tij në përfundimin efektiv të procedurave duke pranuar fajin, se ai është i dobët në aspektin material dhe pronësor, gjendjen e tij shëndetësore duke marrë parasysh që ai vazhdimisht po trajtohet për problemet mentale kurse si rrethana rënduese meren parasysh: fakti se pala e dëmtuar pajtohet me aktakuzaën e prokurorit publik dhe kërkon kompenzimin e dëmeve, kryerja e veprës në vend publike ku ka pasur prezent edhe persona tjer, ikja drejt Italis duke iu shmangur përgjegjësis, keqpërdorimi i besimit të dëmtuarit duke iu afruar si mik dhe shok dhe kryerja e veprës penale, këmngulja e të pandehurit për ta kryer veprën penale duke pasur parasysh këto rrethana si dhe pranimin e fajit të pandehurit gjykata e shpalli fajtor dhe caktoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 7(shtatë) vitesh ku në këtë kohë llogaritet edhe qëndrimi në burg në Itali gjatë kohës së ekstradimit për në Maqedoni po ashtu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim duke filluar nga data 08.11.2016, ku me këtë vendim gjykata konsideron se personi i dënuar do të risocializohet kjo masë e dhënë do të ndikoj që i njëjti në të ardhmen të mos kryej veprë penale të njëjtë apo të ngjashme si dhe do të arrihet qëllimi i dënimit të shqiptuar në aspektin e preventivës gjenerale dhe speciale.

Duke u bzuar në nenet 102 dhe 105 të LPP-, gjykata urdhëroi që i pandehuri të paguante 3,000,000 denarë në llogari të buxhetit të gjykatës në emër të një shume paushale penale, ndërsa në llogari të buxhetit të Republikës së Maqedonisë të rimbursojë kostot e procedurës penale në total. nga 6.500 denarë, prej të cilave 3.500 denarë (nga të cilat 3.500 denarë, në emër të konstatimit dhe mendimit të lëshuar nga Dr. Agim Ramadani, specialis i mjekësisë ligjore dhe kriminologjis dhe një shumë prej 3,000 denarë, në emër të ekspertizës psikiatrike të kryer nga Dr Blagoja Kocevski specialist neuropsikiatrike, të dy në Spitalin Klinik të Tetovës, të gjitha brenda 15 ditëve nga marrja e një aktgjykimi të formës së prerë dhe përmbushjen e të njëjtit me forcë.

Gjykata nga i dënuari në emër të R.M konfison thikën me teh prej 7.5cm si mjet i kryerjes së veprës penale.

Të dëmtuarin xx, nga fshati Pallçisht për kërkesën e paraqitur për kompenzimin e dëmeve e udhëzoi në procedur gjyqësore

Gjykuar në Gjykatën Themelore - Tetovë më 13.07.2017 nën K.Nr.321 / 17.

Daktilograf

Zorica Jovanovska

Kryetar i trupit gjykues

Nazif Iljazi

Udhëzim: E drejta për të apeluar kundër këtij aktgjykimi lejohet brenda 15 ditëve nga marrja e saj përmes kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit në Gostivar.

Përfundimi dhe rekomandimet

Vrasjet e kualifikuara janë ato që shkaktojnë pasoja shumë të mëdha në shoqëri në momentin kur dëgjojmë fjalën vrasje ndiejmë një frikë të pa përshkrueshme, është fenomen i cili fatkeqësisht është prezent edhe në shtetin tonë madje nëse bëjmë një shikim retrospektiv nga e kaluara shohim një numër goxha të madhë të rasteve të vrasjeve sidomos vrasjet e kualifikuara dhe arsyet kanë qenë nga më banolet duke filluar nga “larja e hesapeve” të pasluftës, pastaj hakmarrja dhe deri tek konfliktet fëmijore të tipit se pse po më shikon me mëri dhe kanë përfunduar tragjikisht. Ne si student mundohemi që me njohurit tona të fituara gjatë procesit të edukimit dhe arsimimit të nxjerrim në pah mangësit dhe problemet prezente dhe aktuale të sistemit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit, por nuk mjafton që vetëm të nxjerrim në pah mangësit por duhet që të ofrojmë edhe zgjedhje për problemet që e tangojnë shoqërinë në tërësi.

Fakti se numri i vrasjeve të kualifikuara nga e kaluara në ditët e sodit po zvogëlohet po jep një dritë në fund të tunelit dhe një shpresë e madhe për vet shoqërinë tonë. Luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit në tërësi dhe vrasjeve të kualifikuara në veçanti është një punë shumë e vështirë për organet kompetente duke filluar nga policia, prokuroria, gjykata dhe në fund të zinxhirit janë entet penitensiare të cilat duhet të kryejnë punë të tyre në mënyrë sa më profesionale që të mund të arrihet sukses në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit.

Nuk mjafton që vetëm organet kompetente të jenë në krye të betejës me kriminalitetin por nevojitet edhe shoqëria të kuptojë rëndësinë dhe rolin e saj për parandalimin e kriminalitetit me anë të edukimit të brezave të rinjë të cilët do të arrijnë që të krijojnë një shoqëri dhe shtet stabil dhe mirqeni për të gjithë pa dallime.

Në shumë hulumtime shkencore rëndësi i jepet edhe faktorëve të ndryshëm të cilët ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit në rastin tonë faktorët objektiv dhe subjektiv janë analizuar në mënyrë të detajuar në kapituj më lartë dhe është cekur rëndësia dhe vlera e këtyre faktorëve por nëse kthehemi prapa dhe shtrojmë pyetjen se cilët faktorë kanë ndikim më të madh në shfaqjen e vrasjeve të kualifikuara përgjigjen e saj mund ta elaborojmë në mënyrë si vijojnë që të dy llojet e faktorëve objektiv dhe subjektiv kanë ndikimin e veçantë dhe specifik në shfaqjen e këtyre dukurive kriminale është e vështirë që të ndahen njëri grup nga tjetri dhe të theksohet se faktorët objektiv kanë më shumë ndikim se ato subjektiv apo edhe e kundërta. Këto faktorë mund që të konsiderojmë si kompleks i grupeve të cilët kanë ndikim të veçantë në shfaqjen e kriminalitetit madje në literaturë thuhet se çdo njeri është kriminel potencial por ai nuk është

sporvuar në rrethana të caktuara jetsore që të kryej krime. Vet fakti se jo çdo person jeton në rrethan të njejta jetësore e vërteton faktin se faktorët e ndryshëm kanë ndikim të ndryshëm në kohë dhe rrethana të ndryshme.

Në hulumtimet shkencore është vërtetuar se si kryerës më të shpesht të krimit sidomos në shtetin tonë tek veprat kundër jetës dhe trupit në krye të listës janë meshkujt dhe numri i tyre është shumë më i madhë në krahasim me femrat, madje femrat janë në krye të listës si viktima të krimit sidomos të sulmeve seksuale.

Po ashtu edhe nga të dhënat e siguruar nga enti shtetëror për statistika numri i personave që kanë shkollim të lart janë në krye të listës për kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit kjo informat e hudhën posht konstatimin e më parshëm se si kryerës të krimeve më shpesht janë personat me shkollim të ulët dhe ato që nuk kanë aspak shkollim.

Nga e gjithë puna e realizuar në këtë hulumtim shkencor mund të konstatojm se shoqëria jonë ka nevoj për sundim të ligjit, parandalimi i korrupsionit, vjedhjeve dhe kriminalitetit të jakave të bardha të cilët faktikisht po e përhapin dhe e mundësojnë që në shoqëri të përhapet me hap gjigand fal edhe jo seriozitetit të tyre dhe keqpërdorimit të pozitive dhe pushtetit të tyre në shtet.

Jo rastësisht Tomas Hobs ka thënë që njeriu për njeriun ujk është dhe duke ditur këtë natyrë të njeriut nevojitet që në masë të madhe të edukohen qeniet njerzore në mënyrë adekuate, respektimi i njëri tjetrit në shoqëri, krijimi i kushteve më të mira për jetë, punësimi në bazë të meritokracis do të ishte një bazë e shëndetshme për një shoqëri përparimtare.

Ky fenomen rrezikon një vler shumë të rëndësishme në shoqëri siç është e drejta e jetës e drejt kjo e cila është e përcaktuar në kushtetut dhe në të gjithë aktet tjera nacionale dhe ndërkombëtare dhe shkelja e saj nënkupton shkeljen e kushtetutës mirëpo kjo nuk mjafton që individët të ndalojnë dhe të mos kryejn vepra penale sidomos vrasje të kualifikuara.

Luftimi dhe parandalimi si formë e modernizuar në luftimin e kriminalitetit përfshirë këtu edhe vrasjet e kualifikuara, masat e ndryshme që meren nga ana e institucioneve kompetente për parandalimin dhe luftimin e krimit, ngritja e vëdijs tek qytetarët, ndikimi i vazhdueshëm i mediave të cilat nuk rreshtin së ekspozuari raste të ndryshme kriminale nëpër televizione të ndryshme pa asnjë lloj kriteriumi ku me këto lloj informatash mund të ballafaqohen edhe të rinjët të cilët mund të ndikohen negativisht nga forma se si paraqitet lajmi për kriminaliteti si

dhe shumë faktorë tjerë që duhet hulumtuar për të ardhur në një konkluzion lidhur me krimin dhe kriminalitetin në tërësi.

Pas hulumtimit të realizuar ne mund të paraqesim disa rekomandime lidhur me vrasjet e kualifikuara dhe kriminalitetin në shoqërin tonë. Lidhur me vrasjet e kualifikuara fillimisht nevojitet që të ndërmeren masa të karakterit preventive pastaj masat represive por masa më të ashpërta në krahasim me ato aktuale.

Masat preventive do të ishin më adekuate në qoft se fillonin me ngritjen e vetdijes tek qytetarët në shoqëri pasi që vetdija e lart do të mundësonte edhe efikasitet më të madh në shoqëri për të luftuar kriminalitetin në shoqëri. Fillimi i kampanjave të ndryshme që ti informojn qytetarët për rrezikshmërin dhe pasojat në shoqëri, dëmet që shkaktojnë dhe dëmet në aspektin material dhe financiar të shtetit dhe shoqëris.

Vendosja e lëndëve ndër shkolla që të rinjtë të informohen lidhur me kriminalitetin në shoqëri, masat për të parandaluar kriminalitetin, sanksionet adekuate që të informohen në kohë me dukurit negative dhe pasojat e tyre.

Pas masave preventive dhe mospasësori i tyre atëher hynë në funksion masat represive të cilat domosdoshmërisht do të tregojn efektin e tyre në shoqëri.

Masat e karakterit represiv do të duheshin që nga policia, prokurori, gjykata edhe deri tek entet penitensiare të ndërmarin masat e parapara me ligj dhe kushtetut, funksionim në mënyrë adekuate dhe profesionale të këtyre institucioneve do të realizoheshin qëllimi final i të drejtës penale ndëshkimi i kryerësve të përgjegjshëm si dhe risocializimi i tyre dhe kthimi përsëri në shoqëri si qytetar të denjë.

Ngritja e procedurës që nga policia tek prokuroria dhe në fund sjellja e vendimit gjyqësor respektimi i ligjit dhe akteve tjera i tyre që nga nënpunësit dhe deri tek funksionarët më të lart në organet e lart përmenduar do të mundësonte efikasitetin dhe paanshmërin e tyre në respektimin e ligjit.

Ndëshkimi në bazë të ligjit, mos bishtrimi i ligjit, ndëshkimi çdo person pa pasur parasysht pozitën e tij në shoqëri, pasurin dhe ndikimet tjera që paraqiten për ti shmangur sanksionit penal që duhet të vuajn.

Rëndësi të veçant në zbatimin dhe efikasitetin e ligjit do të arriheshte edhe me vet reformimin e sistemit juridik pasi që shumë keqpërdorime të pushtetit gjyqësor bëhet nga vet individët që janë të punësuar dhe kanë pozita të rëndësishme në sistemin juridik dhe kjo e pamundëson efikasitetin e ligjeve. Reformimi që nga policia e deri tek sistemi juridik është i pa shmangshëm për të evituar shkatrimin në tërësi të sistemit të drejtësis kjo u vërtetua në shtetin tonë me përgjimet që dolën në pah disa vite më parë dhe vërtetuan ndikimet nga politika dhe funksionarët publik të cilët me lidhjet e tyre ndikonin në sjelljen e vendimeve gjyqësore dhe shkatrimin e sistemit gjyqësor në tërësi. Reformimi është detyrim pasi që edhe prokuroria speciale dështoi që të realizoj qëllimin për të cilin u themelua madje u zhytë vet në kriminalitet dhe korrupsion dhe shpresa e vetme është reformimi dhe sjellja e individëve me të kaluar të pastër, personalitet dhe edukim adekuat që të arrihet qëllim kryesor dhe më me vlerë i drejtësis dhe funksionimi i shtetit të së drejtës.

Shpresojmë se nëpërmjet këti hulumtimi do të arrihet që sa do pak në sistemin e drejtësis të shtetit tonë do të ndikojmë në mënyrë pozitive në efikasitetin dhe funksionimin e ligjeve, funksionimin e organeve kompetente nëpërmjet kritikave dhe sugjerimeve drejtuar tyre që sa do pak të përmissohen dhe të mundësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e ligjeve dhe akteve nën ligjore. Shoqëria jonë ka nevojë për reform të thella në çdo sferë por gjyqësori është primar dhe shpresojmë se shumë shpejt do të fillojnë veprimet e nevojshme.

Bibliografia

Libra dhe artikuj shkencorë

- Elezi Ismet, E drejta penale, pjesa e posaçme, Tiranë, 2003
- Kambovski Vlado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2010
- Kambovski V. Komentari i kodit penal të Republikës së Maqedonis, botimi i dytë, Shkup, 2011
- Osmani A. Kodi penal i Republikës së Maqedonisë: teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik Shkup, 2015
- Zejneli Ismail, Kambovski Vlado, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018
- Zejneli Ismail, E drejta penale pjesa e posaçme (cikël leksionesh), Tetovë-2007
- Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Tetovë, 2007
- Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2018
- Sahiti Ejup, Murati Rexhep, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013
- Saliu Ismet, E drejta penale, pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014
- Sulemjanov Zoran, Vrasjet në Maqedoni, Shkup, 1990
- Latifi Vesle, Kriminalistika, Prishtinë, 2015
- Latifi Veseli, Elezi I., Hysi V., Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë, 2012
- Hysi Vasilika, Hyrje në kriminologji me penologji, Tiranë, 2002
- Hysi Vasilika, Kriminologjia, Botimi i dytë i përmisuar, Tiranë, 2010
- Halili Ragip, Viktimologji Prishtinë, 2011
- Halili Ragip, Kriminologji Prishtinë, 2011
- Halili Ragip, Kriminologji Prishtinë, 2016
- Halili Ragip, Disa karakteristike krimnologjike dhe viktimologjike të trafikimit të femrave, E drejta nr.1-4, Prishtinë, 2000
- Halili Ragip, Aspektet juridike dhe krimnologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë, Përparimi nr.2 Prishtinë, 1984
- Halili Ragip, Disa krime dhe shkaqet e tyre në Kosovë në fazën e pasluftës, Vjetari-Buletini nr.1/2000, Prishtinë
- Janev I, Legal Aspects of the Use of a Provisional Name for Macedonia in the United Nations System, AJIL, and Vol 93. Nr.1
- Frojd Sigmund-Qëndresa dhe shtypja-zhvillimi i libidos dhe organizimi seksual, Tiranë-1997

- Milutinović Milan, Politika kriminale, Prishtinë, 1985
- Shtino Nazim, Piliko.Anita, Personaliteti dhe çrregullimet e tij, Tiranë, 2001
- Milutinović Milan, Kriminologjia, Prishtinë, 1982, Botimishqip,vep .cit. faq. 463-464
- Rot Nikolla, Psikologjia e personalitetit, Prishtinë, 1968, vep cit. faq. 130
- Rot Nikolla, Psikologjia e përgjithshme, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1990
- Nushi Pajazit, Psikologjia, Prishtinë, 1996
- Hoti Arben, Psikologjia e personaliteti, Tiranë, 2012

Tekste ligjore: Kushtetuta, Kode, ligje, Konventa:

- Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.150/2010
- Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare R.M-së,nr.57,26.04.2010
- Ligji për gjykatat, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/06 35/08, U. nr. 256/07, U. nr.74/08,150/10, U. Nr . 12/.
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Afrim Osmani, Botimi i dytë, Shkup, 2015
- Kodi Penal i Kosovës
- Konventa Kundër Torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jo njerëzor dhe degradues

Burime nga interneti

- http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat_Sudstvo/125_SK2_ml_T-19.px/table/tableViewLayout2/?rxid=af367976-d387-4c7f-accb-d8cbffe5ff53
- http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat_Sudstvo/450_SK2_ml_T-20_px.px/table/tableViewLayout2/?rxid=af367976-d387-4c7f-accb-d8cbffe5ff53
- <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/sq/dd4f6fc4-42be-4fd6-a4cc-b2ac81b05a7>
- https://books.google.mk/books?id=zJ1hFnP_zlUC&pg=PA24&lpg=PA24&dq=raporti+i+keshillit+te+evropes+per+burgjet&source=bl&ots=peQVn9LoUU&sig=ACfU3U3J8_vDtNGYXmxDMOtUËDFTzLg3Yë&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEëjA8af8n8DpAhWILsAKHRFWD8AQ

[6AEëA3oECAoQAQ#v=onpage&q=raporti%20i%20keshillit%20te%20evropes%20per%20burgjet&f=false](https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/STRATEGJIA%20%202017.pdf)

- <https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/STRATEGJIA%20%202017.pdf>
- <https://empower-journalist.citizens-channel.com/kolapsi-i-industrise-kreative-dhe-fati-i-gazetareve-te-rinj/>
- <https://www.nimh.nih.gov/health/topics/schizophrenia/raise/raise-questions-and-answers.shtml#1>
- <https://www.psiologjadheshendeti.com/neurozat/>
- <https://sq.wikipedia.org/wiki/Inteligjenca>
- <https://mia.mk/levizja-anti-bixhoz-dyshon-se-do-te-ndryshoje-ligji-per-lojerat-e-fatit/?lang=sq>
- <https://skopjeinfo.mk/prostitucija-vo-skopje-zgodni-devojki-se-prodavaat-na-site-strani>
- <https://www.tetovasot.com/2019/08/situat-dramatike-droga-ka-vershuar-tetoven-cdo-dite-kapen-te-rinj-me-marihuane-dhe-kokaine/>
- <http://ckrm.org.mk/dokuments/alkoholizam%20al.pdf>
- <https://mk.ambafrance.org/Permiresimi-i-gjendjes-se-romeve-ne-Maqedoni>
- <http://www.mon.gov.mk/index.php/AL/2014-07-23-14-03-25/vesti-i-nastani-alb/2356-pisa-2018>
- <https://portalb.mk/33138-shoqata-e-te-perndjekurve-padit-maqedonine-ne-strasburg/>
- <https://www.wfp.org/zero-hunger>
- http://www.stat.gov.mk/KlucniIndikator_i_al.aspx
- <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstnie.aspx?rbtxt=17>
- <http://www.stat.gov.mk/IndikatorITS.aspx?id=2>
- <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstnie.aspx?rbtxt=29>
- <http://www.mvr.gov.mk/>
- <https://www.osac.gov/Content/Report/0ea4cf69-2682-43e4-871f-15f4aeae3da3>
- <https://telegrafi.com/ja-sa-eshte-numri-vrasjeve-ne-maqedoni-nga-viti-2000/>
- <https://www.pravdiko.mk/ëp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>
- <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Universale%20e%20t e%20Dreitave%20te%20Njeriut%20%281948%29.pdf>
- <https://www.sobranie.mk/kushtetuta-e-rm-s.nsp>